

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5862
E martë, 27 gusht 2019
çmimi 0.40 €

Veseli viziton Doganën: Falë njerëzve të pakorruptuar është rritur buxheti i shtetit



FAQE 7

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, HASHIM THAÇI, KA MARRË TË HËNËN VENDIM PËR SHPALLJEN E ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME PËR KUVENDIN E KOSOVËS

FAQE 5

Zgjedhjet parlamentare, më 6 tetor

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, mori të hënën vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 6 tetor. Vendimi pason pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës më 22 gusht, gati një muaj pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës. Që nga dorëheqja e Haradinajt partitë politike kanë nisur njëfarëloj fushate ende të pashpallur zgjedhore, ndërkohe që janë arritur edhe koalicionet e para parazgjedhore, si dhe kanë nisur bisedimet ndërmjet partive politike për koalicione eventuale para apo pas zgjedhjeve



Vjosa Osmani, kandidate e LDK-së për kryeministër



Banorët e brezit kufitar do të protestojnë më 2 shtator në shenjë pakënaqësi me vendimin për mbylljen e nëntëmbëdhjetë shkollave fillore në Komunën e Kamenicës. Kryetari i Bashkësisë

Më 2 shtator protestohet kundër mbylljes së 19 shkollave në Kamenicë

Lokale të fshatit Karaçevë e Poshtme, Selver Lenjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se qytetarët nuk do ta lejojnë mbylljen e këtyre shkollave. Ai ka kërkuar nga kryetari të tërhiqet nga kjo kauzë e dëmshme. Kurse

kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se nuk ka mbyllje të shkollave, por riorganizim të tyre. Ai ka theksuar se kjo reformë është domosdoshmëri dhe ndikon në rritjen e cilësisë në arsim

FAQE 4-5

OPINION

LINÇIMI PUBLIK, LEHTËSIM I PASHPJEGUESHËM DHE I PAPANUESHËM GJATË BËRJES SË KOALICIONEVE

F. 13

Behxhet
Sh. SHALA -
BAJGORA



AKTUALE

PËRURORHET LAPARASKOPI I RI NË KLINIKËN E GJINEKOLOGJISË

F. 7

FSK-JA DEMOLON MBI 200 MJETE EKSPLOZIVE TË PASHPËRTHYERA

F. 7

EKONOMI

ODA EKONOMIKE AMERIKANE: DIGJITALIZIMI I EKONOMISË TË JETË NDËR PRIORITETET E QEVERISË SË RE

F. 9

SPORT



MAJLINDA, E BRONZTË NË JAPONI

F. 18

TOPALLI: PAS FERONIKELIT RADHËN E KA LLAPI

F. 18

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curez-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

David McAllister viziton Serbinë

STRASBURG, 26 GUSHT - Kryetari i Komitetit për Politikë të Jashtme në Parlamentin Evropian, David McAllister, po qëndron për vizitë zyrtare në Serbi, ku takoi presidentin e këtij vendi, Aleksandar Vuçiq, dhe zyrtarë të tjerë të shtetit serb. Sipas një komunikate të Qeverisë së Serbisë, McAllister tha se Serbia ka reputacionin e faktorit të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor, por thek-

soi nevojën që ky vend të bëjë më shumë në fushën e sundimit të ligjit.

Ai tha se pret që aktivitetet shtesë të institucioneve serbe të çojnë në hapjen e kapitujve të rinj të negociatave për anëtarësimin e Serbisë në BE.

Vuçiq, në anën tjetër, tha se vendi i tij do të vazhdojë të bëjë reforma në përputhje me porositë e BE-së.

Ai po ashtu tha se Serbia e

mbështet vendosmërisht dialogun për normalizimin e marrëdhënieve me Kosovën, por theksoi se ky dialog është i mundshëm vetëm kur Kosova të heqë taksën ndaj prodhimeve të importuara nga Serbia, raportojnë mediet serbe.

Normalizimi i raporteve është kusht edhe për Serbinë, edhe për Kosovën që të përparojnë në rrugën e integritimit evropian.

McAllister takoi edhe ministrin

për Integritet Evropian të Serbisë, Jadranka Joksimović.

Edhe kjo e fundit tha se Serbia është e gatshme të vazhdojë dialogun me Kosovën, sapo të hiqet taksa ndaj mallrave serbe. Kosova u ka vënë taksë 100% prodhimeve të importuara nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina qysh në nëntor të vitit të kaluar.

Eurodeputeti McAllister po qëndron në Serbi për herë të parë në



cilësinë e kryesuesit të Komitetit për Politikë të Jashtme në Parlamentin Evropian.

Ai më parë ka shërbyer si raportues i PE-së për Serbinë.

Pretendentët republikanë sfidojnë Trumpin për zgjedhjet e 2020-s

Prezantuesi dhe komentatori në radio, Joe Walsh, i njohur për pikëpamje konservatore, ka qenë më parë përkrahës i presidentit, por tani thotë se do ta sfidojë presidentin për kandidaturën republikane në zgjedhjet e 2020-ës

WASHINGTON, 26 GUSHT - Joe Walsh, ish-ligjvënës republikan, ka në plan të sfidojë presidentin Trump në zgjedhjet e 2020. Me shpalljen e kandidaturës, ai bëhet kandidati i dytë që konkurron përballë presidentit Trump për emërimin e Partisë Republikane.

"Unë jam Joe Walsh. Kam qenë ligjvënës republikan. Jam konservator. Po konkurroj pasi Donald Trumpi nuk na përfaqëson ne. Ai përfaqëson më të keqen e Amerikës", tha ai.

Prezantuesi dhe komentatori në radio, Joe Walsh, i njohur për pikëpamje konservatore, ka qenë më parë përkrahës i presidentit, por tani thotë se do ta sfidojë presidentin për kandidaturën republikane në zgjedhjet e 2020.

"Në Shtëpinë e Bardhë kemi dikë që është krejt i papërshtatshëm për t'u bërë president. Jam i shokuar nga fakti që askush nuk ka dalë për ta sfiduar, pasi të

gjithë në Partinë Republikane besojnë se ai nuk është për këtë punë", tha Walsh, ka njoftuar voa.

Walsh nuk është i pari republikan që sfidon presidentin Trump. Ish-guvernatori i Masaçusetsit, Bill Weld njoftoi në prill se po konkurronte në zgjedhjet presidenciale.

Ish-guvernatori i Karolinës së Jugut, Mark Sanford ka diskutuar mundësinë e konkurrimit për president.

Disa komentatorë politikë janë shprehur skeptikë, duke sjellë si shembull mbështetjen që ka presidenti në bazën e tij konservatore.

"Konkurrentëve u nevojitet mbështetja e Partisë Republikane. Presidenti e gëzon këtë mbështetje. Ai gëzon jo vetëm mbështetjen e votuesve, por edhe të partisë. Kjo nënkupton që e mbështetjen kryetarët e degëve të partisë në shtete indi-



viduale, si dhe anëtarësia e partisë në shtete. Zgjedhjet presidenciale zhvillohen në bazë shtetesh. Kur krerët e degëve të partisë e mbështesin presidentin 100 për qind, dikush si Joe Walsh nuk ka si të ketë sukses", thotë opinionistja Alice Stewart.

Walsh, i cili u zgjodh për një mandat në Kongres, ka qenë

kritik i fortë i ish-presidentit Barak Obama, por të dielën shprehu pendesë për disa nga deklaratat që ka bërë në të kaluarën.

"Unë kam ndihmuar për të krijuar presidencën Trump. Nuk ka diskutim që ky element i politikës së shëmtuar ndikoi. Për këtë ndiej pendesë", tha ai.

Në anën demokrate, votuesit po

përpiqen të zgjedhin të preferuarin nga një mori kandidatësh. "Për mua ka rëndësi të marr pjesë në aktivitete fushate, sidomos në shtetin Ajova, pasi në këtë shtet bëhen zgjedhjet e para partiake. Këto aktivitete më ndihmojnë të vendos për kë do të votoj", thotë aktivistja Emily Harris.

Maqedonia e Veriut dhe Serbia me menaxhim të përbashkët të kufirit

SHKUP, 26 GUSHT - Nga e hëna Serbia dhe Maqedonia e Veriut, do të zbatojnë kontrollin e përbashkët të lëvizjes së njerëzve dhe mallrave në vendkalimin kufitar në mes të Preshevës dhe Tabanocës.

Kryeministria serbe, Ana Bërnabiq, dhe kryeministri maqedonas, Zoran Zaev, përuruan fillimin e zbatimit të marrëveshjes për menaxhimin e integruar të kufirit, duke e vlerësuar se ky duhet të jetë shembull për bashkëpunimin rajonal.

Kryeministri Zaev tha se "me këtë

do të shpejtohet lëvizja e udhëtarëve, mallrave dhe automjeteve. Do të rritet numri i turistëve në të dy shtetet dhe i turistëve të cilët kalojnë nëpër dy vendet tona", tha ai.

Ai theksoi se me njohjen e certifikatave ndër-kufitare midis vendit të tij dhe Serbisë, do të shmangen mashttrimet doganore, do të lehtësohet lufta kundër korrupsionit si dhe do të shtohet mirëbesimi dhe tregtia ndërmjet të dyja vendeve, ka njoftuar "VOA".

Kryeministria serbe, Ana Bërnabiq,

tha se sistemi i integruar i kufirit do të mundësojë lëvizjen më të shpejtë të kamionëve dhe do të nxisë tregtinë rajonale.

Ajo shfrytëzoi rastin për të kritikuar vendimin e Prishtinës zyrtare për vendosjen e tarifave prej 100 për qind ndaj mallrave serbe dhe atyre të Bosnjë e Hercegovinës, duke përsëritur thirrjen për heqjen e tyre.

"Serbia, do të kërkojë rrugë alternative përmes marrëveshjeve me shtete të tjera për zhvillimin e tregtisë", tha kryeministria serbe.



Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) ka vendosur për kandidatin e kësaj partie për kryeministër

Vjosa Osmani, kandidate e LDK-së për kryeministre

Ish-deputetja më e votuar në Kosovë, Vjosa Osmani, do të jetë kandidate e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) për kryeministre. Kështu ka vendosur të hënën Kryesia e LDK-së në mënyrë unanime. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka treguar se në garë për këtë post ishte edhe Lufti Haziri, i cili më pas i ka dhënë mbështetje Vjosa Osmanit. Kjo e fundit ka thënë se bashkërisht me qytetarët do ta kthejnë Kosovën në rrugë të drejtë

**EPOKA
ERE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryesia e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK) në mënyrë unanime ka vendosur që Vjosa Osmani të jetë kandidate e kësaj partie për postin e kryeministrit. Kryetari i LDK-së, Isa Mustafa, ka treguar se në këtë garë ka qenë edhe Lutfi Haziri, por i cili, në fund, ka hequr dorë, duke i dhënë mbështetje Vjosa Osmanit. "Nuk kemi bërë dallime kush ka merita më shumë e më pak, por edhe mbi bazën e vullnetit dhe propozimit të Lutfi Hazirit, jemi përcaktuar që kandidat ynë për kryeministër dhe jo vetëm kandidat, por edhe kryeministre e ardhshme e Kosovës, të jetë Vjosa Osmani", ka thënë Mustafa në konferencën për media.

Kandidatja për kryeministre, Vjosa Osmani, ka theksuar se bashkërisht me qytetarët do ta kthejnë Kosovën në rrugë të drejtë. "Jo rastësisht në tridhjetë vjetët e fundit historia e LDK-së, edhe Kosovës, është përcaktuar pikërisht në vendin ku partia më e madhe i ka ndërtuar politikën për këtë vend. Dua t'i falënderoj të gjithë kolegët, së pari kryetarin Mustafa, për mbështetjen për të gjithë ne që si shumë të ri e

kemi filluar rrugëtimin tonë në politik, por edhe secilin koleg tjetër që sot më dha mbështetjen unanime që bashkërisht me qytetarët e Kosovës ta kthejmë vendin në rrugë të drejtë, që bashkërisht me qytetarët ta nxjerrim këtë vend nga humnera që e kanë futur njerëzit e pandërgjegjshëm, të korruptuar, që asnjëherë interesin e qytetarëve nuk e kanë pasur prioritet", ka thënë ajo. Më tej, ajo është zotuar se do të jetë zëri i të gjithë qytetarëve të Kosovës. "I garantoj qytetarët që nga sot asnjëherë nuk do të ndihen se nuk kanë zë, në veçanti gratë, vajzat dhe nënat", ka thënë Osmani.

Ndërsa nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, ka thënë se bashkërisht si ekip do ta kthejnë LDK-në në rrugën e fitores. "Kjo periudhë kohore prej 3 gushtit na ka shërbyer për organizimin në mënyrë tonë dhe në kulturën tonë politike për përgatitjen për zgjedhje. Mos e merrni për kurrjë tjetër, sepse jashtë nesh mënyrën si vendosim nuk po na kuptojnë të tjerët, por është kulturë e LDK-së ku durimi, toleranca dhe bashkëpunimi me racionalitet gjithmonë ka sunduar si vlerë politike", ka thënë Haziri, duke shtuar se Vjosa Osmani do të jetë kryeministre e ardhshme e Kosovës.



Mustafa kompetencat e kryetarit të LDK-së ia delegon Lutfi Hazirit

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka bërë me dije se kompetencat e kryetarit të partisë gjatë fushatës zgjedhore ia ka deleguar nënkryetarit të kësaj partie, Lutfi Hazirit. Në konferencën për media, ku u prezantua Vjosa Osmani kandidate e LDK-së për kryeministre, Mustafa ka thënë se këtë e ka bërë për shkak se ai gjatë fushatës nuk mund të jetë në terren. "Z. Lutfi Haziri do të ketë rol kyç në politikën e LDK-së dhe në organizimin e fushatës. Meqenëse unë gjatë kësaj periudhe nuk mund të jem

në terren, unë ia kam deleguar të gjitha kapacitetet e mia si kryetar i LDK-së, që ato t'i ushtroj z. Lutfi Haziri, pra që ta organizojë fushatën dhe të bashkëpunojnë bashkë me Osmanin që ne t'i fitojmë zgjedhjet", ka thënë Mustafa, duke shtuar se ata do ta formojnë edhe një ekip për fushatë. "Ne përpos kandidates për kryeministre dhe aktivitetit të z. Haziri në këtë proces do ta caktojmë ekipin në mënyrë që fitorja jonë të jetë fitore ekipore. E njerëzve që do të jenë shtytës të fushatës", ka thënë Mustafa

Analistët: Kandidimi i Vjosës ishte vullnet i elektoratit të LDK-së

Njohësit e rrethanave politike kanë bërë me dije se kandidimi i Vjosa Osmanit për kryeministre ishte vullnet i elektoratit të LDK-së. Analisti politik Imer Mushkolaj ka thënë se tani mbetet të shihet nëse ky vullnet nuk do të shkelet pas zgjedhjeve nga bosët e partisë siç ka ndodhur deri tash. "Kandidimi i Vjosës ishte vullnet i elektoratit të LDK-së. Mbase ky vullnet nuk do të shkelet pas zgjedhjeve, nga bosat e partisë, siç ka ndodhur deri tash", ka shkruar Mushkolaj në llogarinë e vet në "Facebook". Të njëjtin mendim e ka edhe analisti

Astrit Gashi. "Kandidimi për kryeministre i Vjosa Osmanit është dëgjim i drejtë i kërkesës së elektoratit të LDK-së. Kushdo tjetër që do ta merrte këtë pozicion, do të ishte injorim i tij. Vjosa ka qenë kërkesa e të gjithë votueeve të LDK-së që e duan partinë e tyre, andaj kandidimi i saj është edhe i duhur, edhe i merituar. Ajo është kandidatja e parë femër si dhe garanci më e madhe se LDK-ja pas zgjedhjeve nuk do të përfundojë në shtratin e PDK-së", ka shkruar Gashi në profilin e vet në "Facebook".



Vazhdon debati për procesin e ristrukturimit të nëntëmbëdhjetë shkollave fillore në Komunën e Kamenicës

MË 2 SHTATOR PROTESTOHET KUNDËR MBYLLJES SË 19 SHKOLLAVE NË KAMENICË

- Qëndron Kastrati: Riorganizimi i shkollave në të mirë të nxënësve, askush nuk mbetet pa punë

Banorët e brezit kufitar do të protestojnë më 2 shtator në shenjë pakënaqësi me vendimin për mbylljen e nëntëmbëdhjetë shkollave fillore në Komunën e Kamenicës. Kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Karaçevë e Poshtme, Selver Lenjani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se qytetarët nuk do ta lejojnë mbylljen e këtyre shkollave. Ai ka kërkuar nga kryetari të tërhiqet nga kjo kauzë e dëmshme. Kurse kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë se nuk ka mbyllje të shkollave, por riorganizim të tyre. Ai ka theksuar se kjo reformë është domosdoshmëri dhe ndikon në rritjen e cilësisë në arsim. Sipas Kastratit, ky proces është në të mirë të nxënësve dhe nuk do të largohet askush nga puna

EPOKA E RE

Shqipe HETEMI

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Karaçevë e Poshtme, Selver Lenjani, ka bërë me dije se më 2 shtator do të protestohet kundër mbylljes së nëntëmbëdhjetë shkollave fillore në Komunën e Kamenicës, përkatësisht në brezin kufitar. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se mbyllja e këtyre shkollave është shqetësuese për banorët e Karaçevës prandaj, sipas Lenjanit, nuk do të mbetet gurë pa lëvizur për të parandaluar një gjë të tillë. "Në mesin e 19 shkollave për të cilat kryetari i komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka marrë vendim me i mbyll është edhe Shkolla Fillore 'Asllan Thaçi', me 100 nxënës në Karaçevë të Poshtme. Në listë të mbylljes është edhe shkolla 'Avni Rustemi' me

102 nxënës në Karaçevë të Epërme. Mbyllja e këtyre shkollave është shqetësuese për banorët e Karaçevës, prandaj nuk do të lejojmë të ndodhë kjo. Do të jemi këmbëngulës në këtë drejtim dhe nuk do të lëmë gurë pa lëvizur për të arritur sukses. Është marrë vendim që më 2 shtator të protestojmë kundër mbylljes së shkollave shqipe, posaçërisht në brezin kufitar në Karaçevë. Qytetarët e Komunës së Kamenicës do të vihen në mbrojtje të shkollave të tyre dhe kjo është e vetmja mundësi për t'i mbrojtur ato", ka deklaruar Lenjani.

Ai ka kërkuar nga kryetari që të tërhiqet nga kjo kauzë e dëmshme. Lenjani ka thënë se fjalën e fundit për këtë do ta japin prindërit dhe qytetarët të cilët nuk do ta lejojnë bartjen e këtyre nxënësve në shkollat tjetra. "Kërkoj nga institucionet më të larta të Kosovës që të mos lejojnë mbylljen e 19 shkollave. Mbyllja e këtyre shkollave është politikë e gabuar e kryetarit. Ky vendim ka zhgënjyer banorët e kësaj ane. Kërkojmë nga kryetari Qëndron Kastrati të tërhiqet nga kjo kauzë e dëmshme. A ka turp më të madh sesa mbyllja e këtyre e

shkollave të cilat i kanë mbijetuar edhe kohës së Millosheviqit", është shprehur Lenjani, duke shtuar se 200 mësimdhënës rrezikojnë të mbesin pa punë nëse ndodh mbyllja e këtyre shkollave. "U bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve nga brezi kufitar që më 2 shtator t'i dërgojnë nxënësit në shkollat e tyre dhe të fillojë procesi mësimor. Shkollat duhet të jenë në duart e nxënësve dhe mësimdhënësve dhe jo në duart e politikës. Me mbylljen e këtyre 19 shkollave 200 punëtorë do të mbesin pa paga. Ky vendim do t'i kontribuojë varfërisë në Kamenicë", ka theksuar ai. Sipas Lenjanit, nëse protesta e 2 shtatorit nuk do të ketë sukses atëherë më 5 shtator do të organizohet protesta për dorëheqjen e kryetarit Kastrati. "Nëse më 2 shtator nuk tërhiqet kryetari nga vendimi për mbylljen e shkollave, atëherë më 5 shtator do t'i vazhdojmë protestat për dorëheqjen e kryetarit Kastrati. Pavarësisht prej gjendjes në Luginë të Preshevës dhe raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë, shumë shkolla fillore në Komunën e Bujanocit me 23 e 25 nxënës funksionojnë. Madje ka shkolla atje që funksionojnë edhe



me 2 apo 3 nxënës", ka deklaruar Lenjani, duke shtuar se reagimi i SBASHK-ut për këtë çështje ka qenë shumë i vonuar.

Qëndron Kastrati: Riorganizim i shkollave është në të mirë të nxënësve, askush nuk mbetet pa punë

Ndërsa kryetari i Komunës së Kamenicës, Qëndron Kastrati, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se nuk do të ketë mbyllje të shkollave, por riorganizim të tyre. Ai ka theksuar se kjo reformë ka për synim që mos të ketë më pak se 20 nxënës në klasë dhe më pak se dy paralele në gjeneratë. Sipas Kastratit, nga ky proces nuk do të pësojë askush. "Nuk do të ketë mbyllje të shkollave, por riorganizim. Në fakt, vendimi ende nuk është nxjerrë, por jemi duke diskutuar për këtë. Është e padrejtë që qytetarët të mos kenë edukim dhe arsimim cilësor e të shëndoshë. Për arsye të ndryshme nuk kemi arritur t'ua shpjegojmë mjaftueshëm këtë proces, sepse një grup i mësimit në shkollë nuk e shpërndanë informatën drejt. Ne e kemi shtetën që i ka caktuar disa rregulla dhe për mua çfarëdo që është sipas rregullave e respektoj. Në këtë rast duhet të kuptohet se cila është përgjegjësia dhe mandati i kryetarit të komunës", ka deklaruar Kastrati.

Ai ka thënë se procesi i riorganizimit të 19 shkollave fillore në Komunën e Kamenicës po bëhet për të mirën e nxënësve. Duke folur për funksionimin e këtyre shkollave, Kastrati ka treguar se janë 25 klasë me nga 1 nxënës dhe 19 klasë të tjera me nga 2 nxënës. "Unë tërhiqem veç nëse ata me bindin se kjo nuk është në të mirën e nxënësve. Riorganizimi i shkollave ndikon në rritjen e cilë-

sisë sepse mundëson që në shkollat e mbetura t'i kemi mësimit më të mirë. Ky riorganizim mundëson investime të qëndrueshme në infrastrukturë, por edhe menaxhim më efikas të shkollave. Për grupet e tjera të interesit që mundohen të përfitojnë në kurriz të fëmijëve më vjen keq, por nuk kam çfarë të bëj. Subjekteve politike nuk u intereson a po rregullohet cilësia në arsim apo çfarë po ndodh, por vetëm mundohen ta qesin në pozitë të keqe kryetarin. Mua më intereson cilësia në arsim, për çka e kam përgjegjësinë dhe mandatin, kurse atyre u intereson diçka tjetër, që për mua nuk ka peshë dhe vlerë. Duhet të kemi parasysh se është me rëndësi që këta fëmijë, kjo gjeneratë, të rritet si duhet. I kemi 25 klasë që janë vetëm me nga një nxënës. I kemi 19 klasë që janë vetëm me nga 2 nxënës", është shprehur Kastrati duke shtuar se këta nxënës, nëse vazhdojnë kështu, nuk do t'i kenë shkathësitë dhe aftësitë që është dashur t'ua ofrojë arsimi.

Më tutje kryetari Kastrati ka bërë me dije se qëllimi i reformës nuk është largimi i njerëzve nga puna dhe rëndimi i gjendjes. Ai ka thënë se tashmë janë paraparë masat që nuk e lënë askënd në rrugë. "Nuk është e vërtetë se 200 punëtorë do të mbesin pa punë. Asnjë mësimitdhënës nuk do të mbesë pa punë dhe pa të ardhura. Çka dëshiron të bëjë sindikata është tjetër çështje. Prej meje e kanë mundësinë që asnjëri prej tyre të mos mbetet pa të ardhura dhe, minimumi, 70 për qind të pagës. Brenda dy-tri vjetësh shumë mësimitdhënës në Kamenicë do të jenë tepër. Nëse i trajtojmë individualisht ata shkojnë te shtëpia dhe mbesin pa asgjë, por nëse e bëjmë zgjidhjen tash, asnjë prej tyre nuk do të mbesë pa të ardhura. Juridikisht kjo quhet risistemim i mësimitdhënësve dhe nuk hiqet askush prej punës", ka thënë Kastrati.

Megjithatë, sipas tij, ky proces po përdoret politikisht në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare. Kastrati ka thënë se nga ky proces mund të humbë politikisht vetëm ai. "I kam takuar të gjitha subjektet politike në nivel lokal dhe qendror si dhe të gjitha palët e tjera. Të gjithë kanë thënë se ky proces do të jetë në të mirë të nxënësve dhe të mësimitdhënësve. Ne e dimë se kjo reformë nuk është popullore, e dimë se zbatimi i kësaj reforme mund t'i kushtojë qeverisjes aktuale, por jemi të bindur se prej saj do të përfitojnë nxënësit. Ata duhet të kenë edukim cilësor dhe të shëndosh që në të ardhmen t'i kenë të zhvilluara aftësitë dhe shkathësitë në mënyrë që të jenë të konkurrueshëm në Kosovë, rajon dhe më gjerë. Në vitin 2019 nuk duhet të ketë dallim në arsimim pse dikush është i fshatit apo i qytetit. Pavarësisht se ku jeton, arsimi duhet të jetë i njëjtë. Prandaj u bëj thirrje subjekteve politike që të mos kalkulojnë vetëm sa për t'i marrë disa vota, por të punojmë në të mirë të nxënësve", ka thënë Kastrati.

Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë të hënën vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Kosovës

Zgjedhjet parlamentare, më 6 tetor

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, mori të hënën vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës më 6 tetor. Vendimi pason pas shpërndarjes së Kuvendit të Kosovës më 22 gusht, gati një muaj pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës. Që nga dorëheqja e Haradinajt partitë politike kanë nisur njëfarë lloj fushate ende të pashpallur zgjedhore, ndërkohë që janë arritur edhe koalicionet e para parazgjedhore, si dhe kanë nisur bisedimet ndërmjet partive politike për koalicione eventuale para apo pas zgjedhjeve

**EPOKA
ERE** Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, ka marrë të hënën vendim për shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe ka caktuar ditën e diel, 6 tetor 2019, datë për mbajtjen e zgjedhjeve. Në vendimin e nënshkruar thuhet se "duke u bazuar në përgjegjësitë kushtetuese dhe ligjore, presidenti Thaçi ka marrë vendim që zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbahen më 6 tetor 2019". "Udhëzohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i Republikës së Kosovës t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për organizimin dhe mbajtjen e zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në përputhje me këtë vendim dhe legjislacionin në fuqi", thuhet më tej në vendimin të cilin e ka nënshkruar presidenti Thaçi.

Po të hënën presidenti Thaçi ka dekretuar shpërndarjen e legjislaturës së VI të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Javën e kaluar, me 89 vota për, 1 kundër dhe 2 abstenime, deputetët e Kuvendit të Kosovës kanë votuar për shpërndarjen e legjislaturës së gjashtë, duke e çuar vendin në zgjedhje të parakohshme parlamentare. Propozimi i deputetëve për shpërndarjen e Kuvendit pason pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga pozita e kryeministrit të Kosovës më 19 korrik, pasi të njëjtën ditë kishte marrë ftesë nga Gjykata Speciale e Kosovës me seli në Hagë, për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Që nga dorëheqja e Haradinajt, partitë politike kanë nisur një lloj fushate ende të pashpallur zgjedhore. Ndërkohë që janë arritur edhe koalicionet e para parazgjedhore si dhe kanë nisur bisedimet ndërmjet partive politike për koalicione eventuale para apo pas zgjedhjeve. Aleanca për Ardhmërinë e

Kosovës (AAK) ka lidhur koalicion parazgjedhor me Partinë Socialdemokrate (PSD), kurse Nisma Socialdemokrate ka lidhur koalicion me Aleancën Kosova e Re (AKR). Zgjedhjet e fundit parlamentare në Kosovë u mbajtën më 11 qershor 2017. Sipas të dhënave të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, numri i votuesve të regjistruar atë kohë ishte 1.888.059, kurse pjesëmarrja në zgjedhje ishte 43 për qind, apo 779.729 votues. Pas zgjedhjeve të vitit 2017, ishte konstituuar Kuvendi dhe më pas, më 9 shtator, ishte formuar edhe Qeveria e Kosovës, me Ramush Haradinajn kryeministër. Përfundimi i mandatit të qeverive dhe legjislaturave të Kosovës para skadimit të mandatit kushtetues, katërvjeçar, tashmë është bërë "praktikë", ngaqë që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës asnjë qeveri nuk arriti ta përmbyllë mandatin kushtetues, çka sjell si rezultat mbajtjen e vazhdueshme të zgjedhjeve të parakohshme.



Në Universitetin 'Ukshin Hoti' nisi punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare

PRIZREN, 26 GUSHT (ER) - Në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren të hënën ka nisur punimet Konferenca Shkencore Ndërkombëtare me tematika të ndryshme nga shkencat e natyrës dhe teknologjia, shkencat e jetës dhe teknologjia dhe nga shkencat inxhinierike dhe teknologjia, që do të mbahet deri më 30 gusht. Kjo konferencë organizohet nga UPZ-ja me partnerët, UBT, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Isparta dhe Universiteti Ndërkombëtar i Vizionit. Në Konferencë po marrin pjesë 150 akademikë dhe rektorë nga Turqia, Polonia, Italia, Kroacia dhe Shqipëria.

Rektori i Universitetit të Prizrenit, prof. asoc. dr. Ismet Temaj, ka theksuar se është nder dhe privilegj ta bëjë hapjen e punimeve të kësaj ngjarje të rëndësishme në emër të bashko-

rganizatorëve dhe partnerëve: UBT, Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Isparta dhe Universiteti Ndërkombëtar i Vizionit. "Gjatë këtyre ditëve u urojmë sukses studiuesve nga vendi, rajoni dhe me gjerë, për prezantimin e punimeve me tematika të ndryshme nga shkencat e natyrës, shkencat e jetës dhe nga shkencat inxhinierike dhe teknologjia", theksoi rektori Temaj.

Ai tha se këtë vit kjo është konferenca e dytë shkencore që zhvillon punimet në Universitetin e Prizrenit, ndërsa shumë të tilla janë organizuar për çdo vjet që nga themelimi. "Këto ngjarje janë dëshmi që në këtë universitet është punuar dhe po punohet me përkushtim për arritjen e synimeve që i kemi vënë përpara, si universitet konkurrent serioz me universitetet brenda dhe jashtë vendit. Ndërkaq sfidat me të cilat



po ballafaqohemi tani besojmë se do t'i tejkalojmë me punë së bashku", ka thënë rektori Temaj. Qëllimi i konferencës është të kontribuojë në zhvillimin shkencor duke diskutuar për studimet e shkencëtarëve që janë të përf-

shirë në hartimin e produkteve inxhinierike me aftësi të qëndrueshme të projektimit dhe krijimin e një ndikimi të qëndrueshëm në gjeneratat e ardhshme.

Krijimi i njohurive dhe të kup-

tuarit përmes shkencës na bën të pajisur për të gjetur zgjidhje për sfidat e sotme ekonomike, sociale dhe mjedisore, për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm dhe më shumë shoqëri të gjelbra.

Policia arreston disa persona të dyshuar për fajde

EPOKA E Qendresa RAMA

PRISHTINË, 26 GUSHT - Policia e Kosovës (PK), në funksion të realizimit të detyrave dhe autorizimeve ligjore, ka ndërmarre veprime të vazhdueshme për zbatimin e strategjive dhe planeve policore që ndërlidhen me luftimin e dukurive negative, krimin e organizuar si dhe aktiviteteve ilegale në përgjithësi, të cilat mund të ndikojnë drejtpërdrejt apo tërthorazi në sigurinë e përgjithshme apo mirëqenien e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst janë realizuar edhe një numër i madh i operacioneve policore në shkallë vendi duke përfshirë edhe luftën e pakompromis kundër veprave penale që, sipas Kodit Penal, cilësohen 'fajde' dhe si rezultat i këtyre përpjekjeve dhe operacioneve intensive janë arrestuar persona të dyshuar, janë



sequestruar dëshmi të ndryshme, përdërisa rastet e tilla në konsultim me prokuroritë përkatëse janë trajtuar dhe proceduar konform ligjeve të aplikueshme. "Javën që po lëmë pas (datë 23. 08. 2019) Policia e Kosovës, konkretisht Drejtoria për Hetimin e Krimin të Organizuar, pas pranimit të një informate se dy persona të dyshuar janë të përfshirë në

vazhdimësi në vepra penale, 'fajde', 'detyrim' etj. menjëherë, në koordinim me organet kompetente të drejtësisë, konform procedurave, ka realizuar kontrollin e lokacioneve të të dyshuarve të përfshirë. Operacioni policor ka filluar më 23. 08. 2019 në orën 14:30 në dy lokacione, me përkrahjen e NJSO-së në Prishtinë dhe një njësi nga

Drejtoria e Krim - Teknikës. Gjatë këtij operacioni janë sequestruar: një revole e tipit 'berandeli' 7.65 mm, një karikator me pesë fishekë, një veturë, një DVR dhe disa dokumentacione relevante për rastin", është theksuar në njoftimin e Policisë së Kosovës.

Sipas këtij njoftimi, i dyshuari i parë nuk është gjetur në shtëpi andaj i njëjti është në kërkim policor, kurse i dyshuari i dytë është arrestuar dhe me urdhër të prokurorit ishte dërguar në mbajtje. "Pas angazhimeve intensive të policisë dhe prokurorisë një ditë më vonë është arritur identifikimi dhe arrestimi i personit të dytë që ishte në kërkim, të cilit i janë sequestruar tre telefona celularë dhe i njëjti është dërguar në mbajtje për procedura të mëtejme", është theksuar në këtë njoftim.

Më 24 gusht, policia ka arrestuar edhe dy persona të tjerë si të dyshuar të implikuar në rastin e lartpërmendur dhe hetimet janë në proces.

Policia, bazuar në mandatin e saj ligjor, mbledh dhe analizon të dhëna për dukuri të ndryshme kriminale, të cilat mund të paraqesin rrezik për shoqërinë dhe njëkohësisht bën planifikime operacionale për parandalimin e veprave penale, në rastin konkret të fajdesë dhe detyrimit.

Qëllimi i këtyre operacioneve policore është identifikimi, parandalimi, hetimi dhe arrestimi i të dyshuarve që në çfarëdo mënyrë janë të inkriminuar me vepra penale të fajdesë dhe detyrimit. "Bashkëpunimi i ngushtë me Prokurorinë e Shtetit, lidhur me luftimin e këtyre veprave penale si dhe bashkëpunimi me qytetarët në këtë drejtim, kanë dhënë rezultate. Andaj kërkujmë që qytetarët tanë që mund të jenë viktima të këtyre rasteve dhe kushdo tjetër që ka informacione relevante, ta njoftojë Policinë e Kosovës", është thënë në njoftimin e Policisë së Kosovës.

MAShT-i dhe Ambasada e Kroacisë nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi në fushën e arsimit

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi dhe ambasadorja e Kroacisë në Kosovë, Marija Kapitanoviq, kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Kosovës dhe Kroacisë në fushën e arsimit të mesëm dhe arsimit të lartë.

Ministri Bytyqi ka falënderuar ambasadorën e Kroacisë për

bashkëpunimin e deritashëm në fushën e arsimit, njëherësh është shprehur se ky bashkëpunim do të vazhdojë të thellohet edhe më tutje në të ardhmen.

Ministri Bytyqi ka thënë se kjo marrëveshje vjen si rezultat i angazhimeve të përbashkëta, me konkretizimin e së cilës do të përfitojnë të rinjtë e të dy vendeve dhe është me rëndësi

që kjo marrëveshje përfshin jo vetëm arsimin e lartë, por edhe bashkëpunimin në fushën e arsimit të mesëm.

Ndërsa ambasadorja Marija Kapitanoviq ka falënderuar ministrin për bashkëpunimin e mirë, njëherësh ka theksuar se është me rëndësi që programet, të cilat i kemi vënë para vetes, t'i realizojmë në mënyrën më të mirë të mundshme.



Përrurohet laparaskopi i ri në Klinikën e Gjinekologjisë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 26 GUSHT - Ministri i Shëndetësisë, Uran Ismaili, ka vizituar të hënën Klinikën e Gjinekologjisë në Qendrën Klinikën Universitare të Kosovës (QKUK). Gjatë kësaj vizite ministri Ismaili ka përruruar pajisjen e re të laparaskopit, e cila ka munguar në këtë klinikë në tre vjetët e fundit. Me këtë pajisje, e cila ka kushtuar 86 mijë euro, profesionistët shëndetësorë do të kenë mundësi të realizojnë intervenime kirurgjike me prerje minimale përmes videokamerës së instaluar në të.

Intervenimet me laparoskop ngritin cilësinë dhe sigurinë e intervenimit si dhe shkurtojnë kohën e shërimit të pacientit duke zvogëluar në masë të madhe komplikimet post operative. Gjatë përrurimit të kësaj pajisje, ministri Ismaili ka thënë se lufta kundër korrupsionit gjatë këtyre dy vjetëve ka krijuar mundësi të reja për investime në

shëndetësi. "Duke luftuar korrupsionin kemi rikthyer shpresën dhe besimin e qytetarëve në institucionet publike shëndetësore. Por, krahas kësaj, kemi rikthyer edhe investimet. Jam shumë i lumtur që sot po përrurojmë edhe një pajisje e cila i ka munguar Klinikës së Gjinekologjisë për disa vjet", ka thënë ministri Ismaili.

Drejtori i Klinikës së Gjinekologjisë, Jakup Ismaili, ka thënë se me këtë pajisje pacientëve do t'u ofrohen shërbime moderne të Gjinekologjisë si në të gjithë botën. "Kemi pasur mungesë të kësaj pajisje në tre vjetët e fundit. Kjo është një pajisje shumë e mirëseardhur e cila na mundëson të realizojmë operime moderne që bëhen sot në gjithë botën. Kjo është në të mirë të pacientëve pasi shkurton kohën e shërimit për ta", ka thënë drejtori Jakup Ismaili.

Në Klinikën e Gjinekologjisë në dy vjetët e fundit janë ndërruar shtretërit, janë dërguar një numër i madh i pajisjeve të reja dhe janë transformuar sallat e operacionit.



Vazhdon përkrahja e Britanisë për FSK-në

PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të hënën në takim lamtumirës ambasadorin e Mbretërisë së Bashkuar, Ruairi O'Connell, të cilin e ka falënderuar për kontributin e dhënë në thellimin e marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona.

Presidenti Thaçi dhe ambasadori O'Connell në këtë takim kanë nënshkruar edhe një memorandum mirëkuptimi

ndërmjet Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe, Irlandës së Veriut dhe Republikës së Kosovës, për ta vazhduar mbështetjen për FSK-në.

Presidenti Thaçi e falënderoi ambasadorin O'Connell për punën e tij në Kosovë. "Kemi ngritur bashkëpunimin tonë në nivel edhe më të lartë", u shpreh presidenti Thaçi. Ndërsa duke folur për memorandumun e mirëkuptimit, presidenti Thaçi u shpreh se kjo i hap rrugë

vazhdimin të bashkëpunimit të FSK-së me Britaninë e cila do të sjellë ngritje të mëtutjeshme të aftësive dhe kapaciteteve të FSK-së. "Mbretëria e Bashkuar n? vazhdimësi ka mbështetur Republikën e Kosovës n? t? gjitha fushat. Ne do t? jemi gjithmonë mirënjohës për k?t? mbështetje", ka thënë presidenti Thaçi. Ai e ka falënderuar ambasadorin O'Connell, duke i uruar suksese n? vazhdimin e karrierës s? tij.

FSK-ja demolon mbi 200 mjete eksplozive të pashpërthyer

FERIZAJ, 26 GUSHT (ER) - Në kuadër të operacioneve të pastrimit të fushëbetëve, pjesëtarët e Kompanisë së Çminimit (EOD) të Forcës së Sigurisë të Kosovës (FSK), gjatë javës së kaluar kanë gjetur mbi 200 mjete eksplozive të pashpërthyer në Parkun e Lirisë në Ferizaj. Pas sigurimit të zonës është bërë transportimi i këtyre mjeteve në poligonin e Harilaqit, të cilat janë demoluar nga pjesëtarët e EDO-së të FSK-së dhe ata të EOD-së të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA).

Për vite me radhë Kompania e Çminimit ka qenë e angazhuar për pastrimin e fushave të kontaminuar me mjete të pashpërthyer, ku janë kryer operacione çminimi në pastrimin e shumë fushëbetëve. Forca e Sigurisë së Kosovës, përkatësisht Kompania e Çminimit, vazhdon të mbetet e përkushtuar për ofrimin e sigurisë së qytetarëve ndaj mjeteve të pashpërthyer dhe i lut qytetarët e Republikës së Kosovës që, nëse hasin në ndonjë mjet të dyshimtë, të raportojnë tek organet e sigurisë.



Jep dorëheqje drejtori i Financave në Prizren

PRIZREN, 26 GUSHT (ER) - Drejtori për Financa në Komunën e Prizrenit, Ertan Simitçi, ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë për shkak të një aktakuzë nga prokuroria për keqpërdorim të detyrës. Ai në një konferencë për medie, së bashku me kryetarin Mytahir Haskuka, ka falënderuar këtë të fundit për mundësinë që ia ka dhënë për t'u sqaruar për publikun në raport me aktakuzën e ngritur. Në këtë kontekst, ai ka thënë se ka vendosur të japë dorëheqje nga pozita e drejtorit të

Financave për hir të transparencës dhe llogaridhënies. "Kemi pasur angazhim shumë të mirë me stafin tuaj, por rasti im është rasti i veçantë dhe e di që nuk është lidhur me juve, me mandatin tuaj, por me problematikën e Prizrenit. Duhet të marrim një vendim konkret që qytetarët ta dinë që në Prizren gjithëherë ka pasur transparencë. Nga sot jap dorëheqje nga detyra ime dhe lirohem nga të gjitha akuzat dhe do të merrem vetëm me këtë proces", ka thënë Simitçi.

Ndërsa kryetari i Prizrenit, Mytahir Haskuka e ka quajtur skandalozë ngritjen e aktakuzës ndaj drejtorit të Financave. Simitçi është duke u akuzuar nga prokuroria se në periudhën janar - dhjetor të vitit 2016 në Prizren, në cilësinë e drejtorit në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, ka shfrytëzuar autoritetin zyrtar duke u dhënë disa medieve lokale në këtë qytet para në vlerë prej 11 800 eurosh, pa kaluar fare në procedura të tenderimit, të cilat janë të parapara me ligj.



Shtatë shtëpi do të ndërtohen në Drenas për familjet që kanë nevojë

DRENAS, 26 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, të hënën ka nënshkruar marrëveshje të bashkëfinancimit me organizatën bamirëse "Jetimat e Ballkanit", përkatësisht me hoxhën Halil Kastrati, për ndërtimin e shtatë shtëpive për familjet që kanë nevojë të Komunës së Drenasit. Sipas kësaj marrëveshje të bashkëfinancimit, komuna obligohet që për secilën shtëpi të ndihmojë në vlerën prej 5 000 eurosh, ndërsa pjesa tjetër mbetet nga

shoqata "Jetimat e Ballkanit" përmes donatorëve. Ndërtimi i shtëpive për familjet në nevojë do të fillojë gjatë kësaj jave dhe do të përfundojnë gjatë këtij viti. Kryetari i komunës, Ramiz Lladrovci, ka falënderuar hoxhën Halil Kastratin, shoqatën "Jetimat e Ballkanit" dhe gjithë donatorët për t'i ndihmuar familjet që kanë nevojë për ndërtimin e shtëpive dhe është zotuar se do t'i përmbushë të gjitha detyrimet që dalin nga kjo marrëveshje e bashkëfinancimit.



Përurohet faza tjetër e rregullimit të shtratit të lumit 'Klina'

SKENDERAJ, 26 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, dhe ministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Fatmir Matoshi, kanë përfunduar të hënën fazën tjetër prej 800 metrash të projektit për rregullimin e shtratit të lumit "Klina", përkatësisht distancën prej urës afër xhamisë së qytetit deri tek ura tjetër brenda fshatit Klinë e Poshtme.

Kryetari Jashari ka thënë se është i lumtur që sot filluan punimet për rregullimin e shtratit i cili ka



qenë në gjendje jo të mirë. "Jemi të lumtur që po arrijmë të

investojmë në projekte që u dedikohen ambientit dhe lumit

të vetëm që kemi, kur e mendojmë gjendjen jo të mirë të shtratit dhe vërshimet sezonale që shkaktonin telashe të mëdha për shtëpitë përgjatë rrjedhës. Pra, hap pas hapi, por sigurt, do të vijojnë edhe fazat e tjera të këtij projekti me ndërtimin e gjithë vijës së shtratit deri në fshatin Kuçicë", ka thënë kryetari Jashari. Ndërkaq ministri Fatmir Matoshi ka thënë se është nder i veçantë dhe kënaqësi që në kuadër të shumë projekteve që MMPH-ja ka financuar në Komunën e Skenderajt, po merr pjesë në fil-

limin e përuimit të punimeve në lumin "Klina". "Është një simbolikë dhe një urë afër këtu që na dërgon në Prekaz. Skenderaj nuk është vetëm i Bekim Jasharit dhe qytetarëve, por i gjithë shqiptarisë. Vëmendja dhe përkushtimi i MMPH-së në projekte ambientale për këtë komunë ka qenë jashtëzakonisht i madh. Edhe në të ardhmen do të jetë i vazhdueshëm sepse këtu frymëzohen fëmijët tanë kur vijnë dhe secili shqiptar që vjen në këtë pjesë të bëjë punë të mira", ka deklaruar Matoshi.

Në fshatin Çifllak nis ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare

RAHOVEC, 26 GUSHT (ER) - Në fshatin Çifllak të Komunës së Rahovecit kanë nisur punimet për ndërtimin e objektit të ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare. Në ceremoninë e nisjes së punimeve i pranishëm ishte kryetari i komunës, Smajl Latifi, zëvendësministri i Shëndetësisë,

Ali Berisha, nënkryetari Fatmir Iska, drejtori i Shëndetësisë Samir Mustafa, drejtori i financave Afrim Limani dhe banorë të këtij fshati. Në fjalën e tij të mbajtur në ceremoninë e fillimit të punimeve, kryetari i komunës, Smajl Latifi, u shpreh se një projekti i tillë në këtë fshat ka qenë i

domosdoshëm të ndërtohet dhe se banoret e kësaj ane do të kenë qasjen e tyre më të lehtë në shëndetësi, si një sektor jetik për mirëqenien e qytetarëve. Vlera e projektit për ndërtimin e Qendrës së Mjekësisë Familjare, buxhetit të Komunës së Rahovecit do t'i kushtojë 82,996 euro.



Veseli viziton Doganën: Falë njerëzve të pakorruptuar është rritur buxheti i shtetit

EPOKA E RE | **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Kadri Veseli, bashkë me ministrin e Financave në detyrë, Bedri Hamza, kanë vizituar të hënën Doganën e Kosovës, ku janë njohur me sukseset që ka arritur ky institucion në dy vjetet e fundit. Veseli ka thënë se me luftën kundër korrupsionit nga ministri i Financave, Bedri Hamza, Kosova ka përfituar për dy vjet 700 milionë euro më shumë, të cilat janë investuar për rininë e talentuar në inovacion e ndërmarrësi si dhe në shumë projekte kapitale. "Lufta kundër korrupsionit, nepotizmit, krimin të organizuar, është jo vetëm e drejtë, por edhe e vlefshme. Ne po flasim vetëm duke iu referuar kësaj çka tha ministri i Financave, se cili ka qenë efekti i një ministri të pakorruptuar dhe një drejtori të Doganave të pakorruptuar, 700 milionë euro. Do të thotë 700 milionë euro për dy vjet për buxhetin e Republikës së Kosovës me të cilin e kemi ruajtur stabilitetin makroekonomik. Edhe pse janë rritur investimet kapitale, kemi ruajtur deficitin buxhetor, është 17.1 për qind nga ardhja e ministrit Bedri Hamza. Kemi rritur pagat dhe kemi mundësi prapë me këto 700 milionë euro, të cilat juanë

kursyer nga abuzimi dhe keqpërdorimi nga puna jashtëzakonisht efikase në veçanti nga Dogana, ta rrisim buxhetin tonë, ta kursejmë shtetin, të investojmë edhe në polici, te pensionistët; të investojmë në ngritjen e pagave edhe në sektorin shëndetësor dhe të arsimit dhe në shumicën e sektorëve të tjerë", ka thënë Veseli.

Kurse ministri i Financave në detyrë, Bedri Hamza, ka deklaruar se të gjitha reformat e bëra dhe lufta kundër korrupsionit në këtë sektor kanë pasur shtytjen dhe mbështetjen e rezervë të Veselit. "Nëse i shikojmë të dhënat dhe u referohemi statistikave del se buxheti i Kosovës në raport me vitin 2017, pjesën e ekzekutimit të vitit 2017 dhe pjesën e planifikimit

të vitit aktual kemi një rritje prej 700 milionë eurosh, e kjo është bërë si rezultat i punës së jashtëzakonshme të këtyre zonjave dhe zotërinjve që punojnë në Dogana. Prandaj, kjo është rritje e formalitetit, është luftim i dukurive negative. Dogana është një institucion jashtëzakonisht mirë i ndërtuar dhe është model edhe për vendet e tjera dhe unë jam i

sigurt se përkrahja e institucioneve do të vazhdojë dhe sukseset pozitive të Doganës do të vazhdojnë", u shpreh Hamza. Edhe drejtori i Doganës, Bahri Berisha, ka falënderuar Veselin për mbështetjen e vazhdueshme për punëtorët e Doganës si për rritjen e pagave, po ashtu edhe për forcim të legjislacionit kundër korrupsionit.



Oda Ekonomike Amerikane: Digjitalizimi i ekonomisë të jetë ndër prioritetet e qeverisë së re



PRISHTINË, 26 GUSHT (ER) - Digjitalizimi i ekonomisë së Kosovës është një ndër parakushtet për zhvillimin e mëtejshëm të bizneseve, lehtësimit të ofrimit të shërbimeve të tyre në treg, por edhe rritjes ekonomike të Kosovës. Kjo u tha gjatë tryezës së organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë ku përfaqësuesit e bizneseve parashtruan rekomandimet e tyre ndaj qeverisë së ardhshme në lidhje me digjitalizimin e ekonomisë. Kryesuesi i Komitetit të

Ekonomisë Digjitale të Odës Amerikane, Ardian Hoxha përmendi mes të tjerash prioritetet e Komitetit të cilin ai e drejton të cilat duhet të merren në konsideratë nga qeveria e re, si krijimi i infrastrukturës ligjore për ekonomi digjitale, shtimi i masave për siguri kibernetike, miratimi i Projektligjit për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara në Transaksionet Elektronike, etj. Ai ka thënë se duke pasur parasysh faktin se sektori i teknologjisë informative dhe të komunika-

cionit mbetet sektori i cili ka rritjen më të madhe në vend, lehtësimi dhe zhvillimi i saj duhet të jetë në fokus të institucioneve qeveritare në mënyrë që vendi të jetë konkurrues me vendet e tjera në rajon dhe botë. Përfaqësuesja e kompanisë amerikane Sutherland, Shpresa Kika ka thënë se njëra ndër sfidat të cilat bizneset e huaja hasin në tregun kosovar është mungesa e qasjes në informata të cilat janë bazike në ofrimin e shërbimeve cilësore ndaj klientëve.

Ministrja Ziviq merr pjesë në Panairin e 57-të Ndërkombëtar të Bujqësisë dhe Ushqimit në Slloveni

SLLOVENI, 26 GUSHT (ER) - Ministrja në detyrë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Dijana Ziviq, ka marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Panairit Ndërkombëtar të Bujqësisë dhe Ushqimit "AGRA 2019" që po mbahet në Gornja Radgona të Sllovenisë, që është organizuar nga Ministria e

Bujqësisë, Pylltarisë dhe Ushqimit e Sllovenisë. Në këtë panair ministrja Ziviq u takua me ministrat e bujqësisë nga vendet pjesëmarrëse në konferencën "Forcimi i gjeneratës dhe transferimi i njohurive për zhvillimin e bujqësisë dhe zonave rurale", me të cilët ajo ka diskutuar bashkëpunimin

në fushën e prodhimit bujqësor dhe industrisë ushqimore. Me këtë rast, ministrja Ziviq ka vizituar standat e ekspozuara në këtë panair dhe pati mundësi të bashkëbisedojë me disa nga ekspozuesit. Fokusi i panairit të këtij viti është digjitalizimi në bujqësi dhe përpunim.



LINÇIMI PUBLIK, LEHTËSIM I PASHPJEGUESHËM DHE I PAPRANUESHËM GJATË BËRJES SË KOALICIONEVE



**Behxhet Sh.
SHALA - BAJGORA**

Telenovela Neymar dhe Agim Bahtiri: U bë përrallë kthimi i Neimarit te Barcelona pasi nuk dëshiron më të luajë në PSG. Barcelona mori 222 milionë euro të buta nga emiri i PSG-së dhe tani dëshiron ta rikthejë, jo duke e paguar shumën e kërkuar, por se ofron 120 milionë dhe dy lojtarë, fillimisht Kutinjon që në ndërkohë kaloi në Bajern dhe Rakitiqin, ndërkaq që PSG-ja kërkonte ato para plus Kutinjon dhe Dembelen për ta përmbyllur këtë telenovelë futbollistike. Deri më tani nuk ka një lëvizje konkrete dhe në lojë janë futur Reali dhe Juventusit. Dhe Feronikeli. Realisht, si simpatizues i Barcelonës u pata gëzuar kur Neimari u largua nga ky ekip për faktin se u pati shndërruar në një simulues që e dëmtonte lojën e Barçës. Ende pa ardhur te topi rrëzohej dhe nuk ishte lojtar që respekton rregullat e lojës. Pastaj, afër një gjeniu të papërsëritshëm siç është Lionel Mesi, mbeti

dhe do të mbetej në hije edhe kur Mesi nuk do të ishte në lojë. Ousmane Dembele është një talent i jashtëzakonshëm dhe vetëm 21-vjeçar. Po të kishte disiplinën e Ronaldos, korrektesinë dhe përkushtimin e Mesit, Neimarin do ta barte për brezi duke luajtur, si virtuoz që është. Mirëpo llastimi i madh po ia dëmton karrierën duke e humbur përkrahjen e Barcelonës e që po e vë në pozitë të Mario Ballotelit dhe Adnan Januzajt që as së afërmi nuk realizuan karrierë në përputhje me cilësitë që i kanë. Ousmane Dembeles duhet t'i jepen 59 friska bythëve për ta lëshuar në tokë ndryshe do të lëvizë nga klubi në klub dhe do të shndërrohet në një mesatarë të zbehtë përkundër se është një diamant futbollistik, deri më tani i pagdhundur dhe i papërpunuar. Duket se edhe humbja e dy rasteve të 100 për qind kundër Liverpulit në Barcelonë pas së cilës u eliminua e ka futur në listën e zezë të Mesit dhe dihet se në Barcelonë Vox Mesi është Vox Dei apo fjala e Mesit është fjala e Zotit. Agim Bahtiri është një personalitet i jashtëzakonshëm që profilin profesional, politik, kombëtar, moral dhe njerëzor e ka formuar në njërën nga shtetet më demokratike në botë ku lejohet përdorimi i barit dhe ku blihen shërbimet seksuale, në Holandën e mullinjve të erës, kanaleve me

ujë dhe tulipanëve. Dhe talentëve të Ajaxit. Si kuadro shumë i nevojshëm, duke i lënë kushtet përralore në Holandë u kthye në Kosovë për të kontribuar, me përvojën e tij të gjatë në rindërtimin e Kosovës dhe të demokracisë. Si formë dhe përmbajtje për veprim politik dhe kombëtar e zgjedhi partinë më patriotike shqiptare, që nga koha e Nikolla Pashiqit e deri më sot, AKR-në që udhëhiqej dhe udhëhiqet nga patrioti më i shquar ndërkombëtar, Behgjet Pacolli dhe për dy mandate e fshiu nga udhëheqja e Mitrovicës PDK-në duke e mundur, së pari Avni Kastratin, të cilin, në vend se Kadri Veseli ta dërgonte në internim, e bëri ambasador në Slloveni. Së dyti e mundi një zonjë të përkushtuar, Valdete Idrizi që e fitoi një çmim ndërkombëtar si femra më e guximshme pasi u rrah mirë e mirë! Po del se për politikën kosovare Agim Bahtiri paraqet vlerë sikur që Mesi paraqet vlerë në futboll. Prandaj nuk është e rastit që Albin Kurti e cilësoi Agim Bahtirin si Hasan Prishtina i ditëve tona e që ne, të painformuarit dhe injorantët besonim se Baca Adem Demaçi është vazhdimësi politike dhe kombëtare e Hasan Prishtinës. Albinin e ka vlerësuar drejt Agimin por edhe Agimi gjithashtu Albinin. U bë një binom i pazëvendësueshëm dhe mbase i vetëm për

bashkimin e Mitrovicës dhe jetësimin praktik të pavarësisë kombëtare, si kusht i domosdoshëm për bashkim të trojeve shqiptare. Agimi, me çifteli dhe sharki, Albinin me politikë. Një politikani të madhërishtë, sakrifikues dhe disident sikur që është Agim Bahtiri i binin ngushtë rrobat e Behgjet Pacolli me të cilin e lidhte vetëm dashuria e madhe për atdheun të cilën, më vonë Pacolli e zëvendësoi me dashuri të madhe ndaj Hashim Thaçit. Agim Bahtiri, disa herë dërgoi sinjale se mund ta braktisë AKR-në për të kaluar në LV sepse koha nuk pret dhe se Kosova, si dhe mbarë shqiptaria gjendet para sfidave të mëdha dhe këto sfida mund t'i bartin në supet e tyre dy herkulët e politikës shqiptare, Agim Hasan Prishtina dhe Albin Kurti. AKR-ja nuk besonte se Agimi, si gjithëherë e ka seriozisht duke luajtur dhe përqeshur me vendosmërinë e Agimit. Dhe në fund, çka nuk e arriti Barcelona me 120 milionë euro dhe dy lojtarë që vlejné 200 milionë euro, e arriti LV-ja duke e transferuar Agimin në LV, pa e shpenzuar edhe as një euro të vetme të parasë publike e që nuk është para e popullit. Me një pompozitet të madh medial, Agim Bahtiri iu bashkua Albin Kurtit, duke mos i vënë kushte shumë të rënda LDK-së për një koalicion parazgjedhor; Albinin kryemi-

nistër sikur edhe dy ministri krejtësisht të parëndësishme siç janë ajo për Punë të Brendshme, (e stupcit) dhe ajo e Drejtësisë (e Dubravës apo e Dyzit). Shumë modest është Agimi. Pas këtij transferi fenomenal filluan sulmet e paarsyeshme ndaj Agimit; dikush e quajti jashtëtokësor, tjetri hajvan me letra, pastaj vjedhës i mandatit, mishngrënës kanibal së bashku me Veselin dhe Thaçin në një tryezë, Agim peçurka, Agim kazanova etj. etj. Realisht, nuk e kam të qartë pse i tëri ky millef dhe urrejtje ndaj Agimit në kohën kur kemi tansfere tjera krejtësisht minore në subjektet tjera politike e që nuk i nënshtrohen rentgenit linçues sikur Agim Bahtiri. Agimi, me këtë transfer ia kaloi edhe përallës për Ali Babën me 40 xuhxhët (gojëkëqinjtë thonë se janë 40 hajna), sepse kaloi në LV me 600 ushtarë të trajnuar dhe të përkushtuar për çështje kombëtare, deri në sakrificën sublime që vetëm AKR-ja di t'i trajnojë! Të shohim ku qëndrojnë subjektet tjera politike me këto dhe kesi transfere.

Lidhja Demokratike e Kosovës: LDK-ja nuk ka bërë asnjë transferim pompoz vetëm se ka bërë lëvizje brenda partisë. Isa Mustafa, me një saktësi prej filligrani, e ka qëndisur partinë sipas nevojave që i ka, gjithsesi afatshkurtra. Me këto lëvizje, Isa Mustafa e ka shpëtuar LDK-në nga një përçarje e thellë të menjëhershme për ta shtyrë këtë përçarje që do të ndodhë pashmangshëm për më vonë kur partia më nuk do t'i duhej asgjë. Nga një luftëtar i prapavijës, me tendencë të pensionimit politik, përmes Këshillit të Përgjithshëm e bëri një rirregullim të brendshëm, duke i eliminuar kundërshtarët që mund t'i rrezikonin planin dhe strategjinë dhe duke krijuar hapësirë për të anatemuarit e dikurshëm, në krye me ingjen Vjosë e cila dikur rrinte fytyrëngrysur sikur të ishte përgjegjëse e vetme për më shumë se 85.000 zjarre në Amazon. Tash, sikur Madona vetëm po buzëqesh, derisa të bëhet kryeministre e Tanzanisë. Thuhet se budallenjtë janë njerëzit më optimistë dhe se dalin me krahasime të denja vetëm me teorinë e relativitetit duke e krahasuar ingjen Vjosë, me Angel (in) a Zholi alias Merkel. LDK-ja akuzon partitë e tjera për korrupsion dhe krim të organizuar në ndërkohë që në Këshillin e Përgjithshëm dhe Kryesinë e LDK-së ka futur anëtarë që kanë bërë disa kundërvajtje të vogla duke vjedhur disa miliona euro, duke punësuar ndonjë vëlla apo djalë ose vajzë (kujdesi primar familjar) apo duke vrrarë një apo disa persona. Shihen kryesinë e re të vjetër të LDK-së, si Çeta e

Elefantëve (Profetëve) që do ta dërgojë këtë parti drejt greminës politike. Dy prurjet shumë premtuese nga shoqëria civile që paralajmëronin reforma dhe demokratizim të brendshëm të LDK-së, Lumir Abdixhiku dhe Driton Selmanaj tashmë u ndanë; Lumi në krah të Isës kurse Dritonin e mori lumi i eliminimeve së bashku me Armendin, Xhaferin, Arbenin dhe të tjerë. Lumiri u tregua më i kujdesshëm duke e eliminuar retorikën e dhunshme kurse Dritoni e forcoi retorikën përjashtuese duke përdorur një fjalor akuzues dhe përjashtues. E humbi garën për kryetar të degës në Prizren dhe tash ka gjasa reale të mos zgjidhet as deputet. Po shoqëria civile nuk është njerëz por është një nënë e madhe që kujdeset për bijtë dhe bijat e braktisura, prandaj Dritoni ka prapavijë të sigurt. Arbeni nuk kaloi për kryesi ndonëse për politikë dhe sjellje është, së paku Ajnshtajn për së paku 90 për qind të kryesisë aktuale. Po këto janë çështje të brendshme të LDK-së dhe nuk duhet të gjykohen nga askush. Kush është kryqëzuar nga hasreti Isai, le të pret mëshirën e Zotit, në rastin konkret në LDK, hasreti Isai është vet Zoti. Ismetin e spostoi nga pozita e sekretarit për ta kandiduar për kryetar të... Hajkobilles. Nëse mediat e kanë treguar drejt se cilat kriteret duhet t'i plotësojë kandidati i LDK-së për kryeministër del se kriteri i dytë qenka qëndrimi i dëshmuar kundër PDK-së e që për mua është qëndrim racist, kushdo që e mbanë këtë qëndrim. Po nëse ky qëndrim mbetet ende në fuqi dhe nëse qenka i vërtetë, e kam një kandidat të shkëlqyer për kryeministër që e urren shumë PDK-në dhe krejt këta të luftës së fundit, Vojislav Sheshelin. Çfarë racizmi, nëse ky kusht është i vërtetë qoftë edhe si kriter i sajuar. Pastaj, LDK-ja apo disa "skifterë" të tredhur të saj që nuk kanë qenë në gjendje ta përzënë macen prej përsheshi, LV-së, midis tjerash i vendosin kusht për koalicion përkuljen dhe përuljen para varrit të Ibrahim Rugovës në ndërkohë që në mënyrën më të turpshme, më të pamoralshme dhe më të poshtër të mundshme e bojkotuan, në mënyrë të organizuar respektin për Bacën Adem Demaçi pasi kaloi në përjetësi, që nga çasti i vdekjes e deri te varrimi! Këta të pafytyrë pastaj të vendosin kushte!!!! Mund të arsyetohet Isa Mustafa që për shkaqe shëndetësore nuk ishte në gjendje të jetë i pranishëm gjatë varrimit apo homazheve por se nuk e kuptoj që dikush të ketë aq shumë urrejtje siç e bëri LDK-ja 100 për qind për rastin e Adem Demaçit. Atëherë Isa Mustafa nuk ishte mirë me shëndet prandaj edhe ndikimi te anëtarët e partisë ishte i vogël

ndryshe, në rrethana normale po t'u thoshte Isa Mustafa anëtarëve të LDJK-së, jo ta nderonin Adem Demaçin por edhe Ivica Daçiqin, këta do ta bënin këtë, disa për hatër të Isës, të tjerët për kujtim të Rrahman Morinës dhe respektit ndaj Ivica Daçiqit. LDK-ja nuk mund të ndërtojë ardhmëri mbi gjuhë të urrejtjes dhe duke përdorur fjalor përjashtues shkaku se nuk kanë koç... por as emri nuk i lejon për këtë. LDK-ja mund t'i fitojë zgjedhjet por se nuk e ka edhe aq të sigurt. LDK-ja nuk duhet t'i vë asnjë kusht LV-së nëse e kanë përnjëmend, sepse kushtëzimi është thirrje për mosbashkëpunim! Partneriteti pa kushte, sjellë rezultate kurse partneriteti i kushtëzuar mund t'iu sjellë pushtet i cili nuk zgjatë shumë. Përralla janë pohimet se LDK-ja dhe LV-ja mund të fitojnë 70 mandate. Për bindjen time, në rastin më të mirë do të kishin 50 mandate, nëse shkojnë me një listë të përbashkët. Koalicioni pas zgjedhjeve është më i qëndrueshëm dhe më efikas. Po e shohim!

Partia Demokratike e Kosovës: Para se t'i vendosnin vija të kuqe, kurse Ismet Beqiri i vuri dy vija të kuqe, PDK-ja kishte aksione shumë të ulëta politike. Tash, me infuzionin që i dhanë subjektet politike në formë të vijave të kuqe, aksionet e PDK-së janë rritur shumë. Madje, nëse shkohet në zgjedhje, pa koalicione të mëdha parazgjedhore, LDK-ja dhe PDK-ja do të luftojnë për vend të parë. Me fajin e subjekteve të tjera politike. Kërcënimi dhe përjashtimi 100 për qind i PDK-së ka mobilizuar anëtarësinë e kësaj partie që është para zgjedhjes hamletiane; të jesh apo të mos jesh, kjo është çështja sot! Subjektet politike po e bëjnë një gabim të madh politik; në vend se publikisht të deklarojnë se do të bashkëpunojnë me të gjitha partitë ku kanë interes e që brenda ta mbajnë qëndrimin që e kanë, duke bërë përpjekje të fitojnë vota, jo në saje të programit politik dhe ekonomik, por në saje të gjuhës përjashtuese, vetëm sa e lënë në lojë PDK-në e cila madje edhe është forcuar. Tash, ta përjashtoni dikë duke u thirrur në të kaluarën kur as vet nuk keni të kaluar të mirë apo edhe keni qenë pjesë e asaj të kaluarë që sot e mohoni, është e pamoralshme dhe politikisht jo në rregull! PDK-ja ka filluar fushatën para shumë kohe duke shkuar nga dera në derë, si lypsarë. As PDK-ja nuk dallon nga partitë tjera duke promovuar dhe reklamuar aderimet, krejtësisht të parëndësishme dhe duke i dhënë peshë sikur të bëhej fjala për vet Çerçillin apo Xhorxh Bushin, Plakun, të Riun dhe më të Riun. Merreni me mend; halla Rukije, në moshën 79-

vjeçare iu bashkua PDK-së për ta luftuar korrupsionin, krimin e organizuar dhe nepotizmin me të vetmin kusht që burri i saj të bëhet ambasador në Leshkoq! PDK-ja po gabon që po bënë seleksionimin e mediave në pozitive dhe negative; Kadri Veseli duhet të shkojë vullnetarisht te Berat Buzhala nëse do të jetë demokrat dhe i besueshëm! PDK-ja nuk është e gatshme për opozitë, jo në baza vullnetare.

Lëvizja Vetëvendosje: LV-ja po i kushton rëndësi të veçantë promovimit të figurave që kanë aderuar në këtë parti ndonëse nga ata nuk do ta kenë as edhe një grusht të votave. LV-ja po gabon rëndë që po i vardiset aq shumë LDK-së dhe i vetmi arsytim është se refuzimin eventual të LDK-së për koalicion parazgjedhor ta përdor si armë kundër LDK-së gjatë fushatës zgjedhore. LV-ja duhet ta ketë të qartë se PSD-ja nuk është pjesë e këtij subjekti dhe se nuk ka nevojë aspak të merret me këtë parti. PSD-ja, nëse asgjë nuk ka bërë, ka merita të mëdha që e ka neutralizuar rolin shantazhues të Listës Serbe dhe këtë LV-ja duhet ta pranojë. LV-ja nuk duhet të vë vija të kuqe ndaj askujt, së paku ndaj PSD-së sepse kjo është pjellë e LV-së. Albini, me fekondim politik ka krijuar PSD-në, fillimisht si embrion i dështuar i FER-it të cilës iu bashkëngjiti edhe një pjesë shumë aktive e LV-së. Përjashtimi në politikë bëhet vetëm për çështje madhore për shtetin dhe kombin e jo për hatërmbetje dhe inate personale. Nuk e besoj se LV-ja është favorite për të fituar zgjedhjet dhe as Albini do të bëhet kryeministër (unë nuk do të kundërshtoj) për shkak të kontekstit ndërkombëtar. Ambasadori i ShBA-ve, Filip Kosnet, pasi u shpërnda Kuvendi i Kosovës doli me një deklaratë ku pika kryesore dhe kyçe ishte se: 'tash Kosova në kohën më të shpejt duhet të formojë institucionet e besueshme për të vazhduar bisedimet me Serbinë me ide të reja dhe kreative ...'. A janë idetë e Albinit dhe të LV-së ide të reja dhe kreative për bisedime me Serbinë sipas kriterëve dhe standardeve të shteteve perëndimore?! Dhe a do të mund Albini ta bëjë kthesën e madhe për bisedime me Serbinë pa e thyer qafën politike?! Qëndrimi i Albinit dhe LV-së për bisedime është logjik dhe i drejtë dhe si i tillë nuk është i pranueshëm për shumë shtete perëndimore që nuk përtojnë edhe një herë ta shqyrtojnë statusin e Kosovës prandaj e tolerojnë Serbinë të vazhdojë me krime kundër Kosovës dhe qytetarëve të saj!

Aleanca për Ardhmërinë e

Kosovës dhe Partia e Kaçushës: AAK-ja, sipas analizave të mia nuk qëndron keq me vota, madje kurrë nuk ka qenë më mirë. Në saje të Ramushit që është lider karizmatik dhe i padiskutueshëm, Dautit që nuk duket fort në publik por se, si në lojën plej stejshën, luan nga hija, dhe rezultatet i ka siç ai i planifikon. E ka edhe Ahmetin e Vogël dhe Teutën e Madhe. E ka një lojtar shumë spirituoze në hije por se është shumë i efektshëm, Besnik Tahirin dhe dy zonja shumë sharmante dhe elokvente, Albenën dhe gruan e Skënderbeut - Donikën. Tash, me këta të PSD-së, jo që marrin shumë vota por se e kanë mprehur shumë tehun goditës për debate e kompletojnë edhe anën tjetër të medaljes. AAK-ja do të ndahet shumë mirë nëse në ndërkohë nuk do të kemi tërmet në Filipine! Edhe këtu kanë aderuar shumë figura të shquara dhe të pashquara, kryesisht sportistë dhe yje apo yllëza të estradës. Dikush po thotë se këta këngëtarë dhe këngëtare të AAK-PSD do të këndojnë pas rezultateve të zgjedhjeve apo, nëse nuk iu del si kanë menduar do të këndojnë në syneti dhe kanagjeqe. Madje, si kuriozitet, në AAK ka aderuar edhe Kaci, më i njohuri që prenjë dhe rruan lesh por se mendoj se më mirë do të ishte të aderonte dikush që me sukses dhe shumicë i rruan votat e të tjerëve.

Nisma për Kosovën dhe Aleanca Kosovare për Rrena (AKR): Nisma për Kosovën bëri koalicion spektakular me AKR-në e cila, as në përrallat e Zhyl Vernit dhe të Ezopit nuk do ta kalonte pragun. Këtu Agim Bahtiri ka plotësisht të drejtë kur thotë se pa te, AKR-ja nuk do ta kalonte as 5 për qind në Mitrovicë. Ky koalicion krejtësisht i panatyrshëm i natyrshëm, ia mundësoi Fatmir Limajt që të bëhet kandidat për kryeministër, në mesin të gjithë kryeministrave të partive tjera. Por, jam i sigurt se Pacollin dhe AKR-në nuk e mbanë në lojë Fatmir Limaj dhe Nisma por, deri sa Hashim Thaçi të ketë frymë politike në Kosovë, fytyra e Behgjet Pacollit do të jetë imazh politik në Kosovë, i pashmangshëm dhe i pazëvendësueshëm. Edhe Fati si dhe Begja deklaruan se ky koalicion do të jetë përcaktues për formimin e qeverisë së ardhshme të Kosovës që nuk e besoj aspak. Madje, mendoj se Nisma pa AKR-në dhe tovarish Pacollin do të fitonte më shumë vota, me AKR-në mund të ndodhë të shkojnë si Romeo e Xhuljeta në recycle been. Kemi filluar të nxehe mi për zgjedhjet e parakohshme për të cilat besoj se nuk do të prodhojnë asnjë ndryshim përveçse do t'i riciklojë të njëjtat politikanë, në ambalazhim tjetër.

Erdogani: Trupat turke të gatshme të ndërhyjnë në lindje të Eufratit

ANKARA, 26 GUSHT - Trupat tokësore turke pritet të hyjnë në lindje të lumit Eufrat në Siri shumë shpejt, deklaroi presidenti turk, Recep Tayyip Erdogan.

"Shpresoj se askush nuk do të përpiqet ta testojë vendosmërinë e Turqisë për t'i pastruar kufijtë e saj me Sirinë nga terroristët", tha Erdogan duke folur në një eveniment në qytetin lindor

Mush me rastin e 948-vjetorit të Betejës së Malazgirit. "Aktualisht, dronët dhe helikopterët tanë kanë hyrë në rajon. Fortifikimet në vendet pranë kufijve tanë po shkatërrohen.

Presim që së shpejti në rajon të hyjnë edhe njësitë tona tokësore", tha presidenti turk. Erdogan shtoi, po ashtu, se Turqia është plotësisht e përgatitur për t'i realizuar planet e saj.



Liderët e G7-ës ofrojnë 22 milionë dollarë për rajonin e Amazonës

Liderët e Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë, Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara janë pajtuar në samitin e shtatë vendeve më të industrializuara (G7) do të ofrojnë 22 milionë dollarë për të ndihmuar në fikjen e zjarreve në rajonin e Amazonës

PARIS, 26 GUSHT - Liderët ndërkombëtarë janë pajtuar në samitin e shtatë vendeve më të industrializuara (G7) që të ofrojnë ndihmë logjistike dhe financiare për të ndihmuar në fikjen e zjarreve në rajonin e Amazonës.

Presidenti francez, Emmanuel Macron ka thënë se këto shtete do të ofrojnë 22 milionë dollarë. Marrëveshja ka ardhur teksa liderët e Kanadasë, Francës, Gjermanisë, Italisë, Japonisë, Mbretërisë së

Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara kanë vazhduar takimin e tyre treditor në Biarritz të Francës. Macroni ka thënë se fondet do të jenë të qasshme menjëherë.

"Franca po ashtu do të ofrojë mbështetje konkrete me ushtrinë në rajon brenda disa orëve", ka thënë Macroni, ka njoftuar rfe.

Kancelarja gjermane, Angela Merkel ka thënë se shteti i saj dhe të tjerëve do të bisedojnë me Brazilin për shpyllëzimin në rajonin e

Amazonës, pasi të shuhen zjarret. "Natyrshisht ky është territor brazilian, mirëpo ne kemi pyetje për këtë rajon, pyetje të nivelit global", ka thënë ajo.

"Mushkëritë e gjithë botës janë prekur, andaj neve na duhet të gjejmë zgjidhje të përbashkëta", tha ajo.

Papa Françesku, po ashtu, u është bashkuar zërave shqetësues për zjarret në Brazil, i cili gjendet në kufi me vendin e tij të lindjes, Argjentinën, dhe u ka bërë thirrje njerëzve të luten në mënyrë që "ato të kontrollohen sa më shpejt që është e mundur".

Ai i ka thënë një turme në sheshin Shën Petri se "ne të gjithë jemi të shqetësuar" për zjarret në Amazonë. Ai po ashtu ka paralajmëruar se "mushkëria e gjelbër

është jetike për planetin tonë".

Presidenti brazilian, Jair Bolsonaro ka thënë përmes një postimi në rrjetin social, Twitter se ai ka biseduar përmes telefonit me kryeministrin izraelit, Benjamin Netanyahu, i cili ka thënë se Izraeli do të dërgojë një aeroplan të specializuar për të ndihmuar në operacionin e luftimit të zjarreve. Të premten, Bolsonaro ka njoftuar për dërgimin e 44,000 ushtarëve për të luftuar zjarret, mirëpo vetëm disa qindra prej tyre tashmë janë dërguar në rajonin e Amazonës.

Agjencia satelitore e këtij shteti ka regjistruar më shumë se 41,000 zjarre në Amazonë gjatë këtij viti, derisa më shumë se gjysma kanë nisur vetëm këtë muaj.

Ekspertët kanë thënë se zjarret janë nisur nga bujqit që kanë pastruar

tokën ku kanë mbjellë. Mirëpo agjencia e njëjtë po ashtu ka raportuar edhe për një rritje të madhe të shpyllëzimit të tokës gjatë këtij viti. Agjencia policore federale në Brazil ka thënë se do t'i hetojë raportimet për bujqit.

Njerëzit kanë protestuar në Rio de Janeiro duke kërkuar nga administrata e Bolsonaros që të bëjë më shumë për të mbrojtur Amazonën. Në disa mbishkrime janë parë edhe këto thirrje: Bolsonaro është duke djegur të ardhmen tonë. Bolsonaro jashtë! Amazona qëndron!

Kritikët kanë akuzuar politikën pro-zhvillimore të Bolsonaros, përmes së cilave janë inkurajuar bujqit që të rrisin shpyllëzimin, ndonëse presidenti ka nisur thirrje të vazhdueshme për mbrojtje të kësaj zone.

Kancelarja Merkel ka përmendur që Bolsonaro është duke dërguar "forca të mëdha" në përpjekje për ruajtje të Amazonës.

Mirëpo Bolsonaro ka pasur marrëdhënie të tensionuara me qeveritë e huaja, duke përfshirë atë të Gjermanisë dhe grupet joqeveritare, pasi i ka akuzuar për ndërhyrje në menaxhimin e shtetit të tij sa i përket Amazonës.

Javën e kaluar, ai ka deklaruar, pa u bazuar në të dhëna, se grupet joqeveritare janë duke nisur zjarret për ta turpëruar atë.

Zyra e Macronit është ankuar të premten se lideri brazilian "ka gënjyer atë" për përkushtimet rreth ambientit.

Ndërkohë presidenti i Bolivisë, Evo Morales, ka thënë të shtunën se ai do të mirëpriste ndihmë për luftimin e zjarreve që kanë përfshirë territorin e tij.

Morales ka thënë në një konferencë me gazetarë se ai ka pranuar oferta për ndihmë nga liderët e Spanjës, Kilit dhe Paraguajit.



Macroni shpreson se Trumpi dhe Rohani do të takohen në javët e ardhshme

PARIS, 26 GUSHT - Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, tha të hënën se po bëhen përgatitje për një takim midis presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, dhe presidentit të Iranit, Hassan Rohani, në javët e ardhshme.

"Dy gjëra janë shumë të rëndësishme për ne: Irani nuk duhet të ketë kurrë armë bërthamore dhe kjo situatë nuk duhet të kërcënojë kurrë stabilitetin rajonal", tha Macroni në një konferencë për

media në fund të saminit të G7-ës, apo grupit të vendeve më të industrializuara, që i zhvilloi punimet në Francë.

Macroni tha se po zhvillohen diskutime për të organizuar samitin Trump-Rohani.

"Ajo çfarë pres në javët e ardhshme, është që t'ia dalim të shohim një samit midis presidentit Rohani dhe presidentit Trump", tha Macroni.

Trumpi dhe Rohani pritet të marrin pjesë në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të

Bashkuara, që do t'i nisë punimet në fund të shtatorit.

Marrëdhëniet midis SHBA-së dhe Iranit kanë shkuar duke u përkeqësuar prejse Trumpi është tërhequr nga marrëveshja bërthamore e vitit 2015 midis Republikës Islamike dhe fuqive botërore.

Pas tërheqjes, SHBA-ja ka kthyer sanksione të fuqishme kundër Iranit, çfarë ka bërë që ky i fundit të braktisë disa pjesë të marrëveshjes bërthamore.



Thesaret miliona euro që u gjetën në plehra

Shufra floriri-Në maj të këtij viti, një pastrues pa emër në Aeroportin Ndërkombëtar Incheon të Koresë së Jugut gjeti shtatë shufra ari me vlerë 330,000 dollarë në një kosh.

Pastruesi i aeroportit i gjeti shufrat e mbështjella me gazetë dhe i dorëzoi në polici. Pronari është identifikuar, por refuzon të pretendojë arin, duke nënkuptuar se shufrat

mund të jenë marrë në mënyrë të paligjshme dhe i hodhi për të shmangur policët ose doganat. Sipas ligjit "Mbajtësit e Gjetjeve" të Koresë së Jugut, pastruesit i

jepet pronësia e shufrave të arit nëse pronari nuk i pretendon ato brenda gjashtë muajve.

Disa njerëz janë bërë me para për shkak të atyre që kanë gje-

tur në plehra. Kanë qenë bizhuteri të shtrenjta, por nuk kanë munguar edhe pikaturat e famshme, ku njerëzit i kanë hedhur nga padituria apo aksidentalisht.



Piktura e famshme- Banorja e Manhattan, Elizabeth Gibson ishte duke bërë një shëtitje në kohën lirë një mëngjesin të vitit në 2003, kur vuri re një kanavacë me ngjyrim të gjallë, të shtrirë në një grumbull plehrash. Gibson kapi pikturën, e mori përsëri në banesën e saj dhe u zuri gjumi. Më pas ajo e çoi atë në faqen e internetit FYI të Antiques Roadshow, ku zbuloi se vepra arti ishte një pikturë e vitit 1970 e quajtur 'Tres Personajes' (Tre persona) nga artisti i mirënjohur abstrakt meksikan Rufino Tamayo. Duket se piktura ishte vjedhur në 1987 nga një depo e Houston. Piktura u ribashkua me pronarin e saj të ligjshëm dhe vazhdoi të shitet për pak më shumë se 1 milion dollarë dhe Gibson mori një shpërblim prej 15,000 \$.



Qilim antik i Turkmenistanit-Në qershor 2010, një grua nga San Diego u përkul përpara specialistit të tekstileve antike, kur ajo solli këtë qilim të vjetër për vlerësim. Disa vjet më parë, një fqinj ishte duke e pastruar dhe kishte hedhur një divan në rrugë. Vajza e zonjës sapo ishte zhvendosur në një vend të ri dhe kishte nevojë për një shtrat. Duke mos harruar sjelljet e saj, zonja kërkoi leje për të marrë divanin dhe ajo i tha se do të hidhte në plehra edhe disa qilima. Nëse i pëlqenin, mund t'i merrte. Qilimi që ajo mori nga mbeturinat ishte thurur rreth vitit 1800 në Turkmenistan dhe është shumë i kërkuar midis koleksionistëve. Ajo u vlerësua me 150,000 dollarë.



Shufra floriri-Në maj të këtij viti, një pastrues pa emër në Aeroportin Ndërkombëtar Incheon të Koresë së Jugut gjeti shtatë shufra ari me vlerë 330,000 dollarë në një kosh. Pastruesi i aeroportit i gjeti shufrat e mbështjella me gazetë dhe i dorëzoi në polici. Pronari është identifikuar, por refuzon të pretendojë arin, duke nënkuptuar se shufrat mund të jenë marrë në mënyrë të paligjshme dhe i hodhi për të shmangur policët ose doganat. Sipas ligjit "Mbajtësit e Gjetjeve" të Koresë së Jugut, pastruesit i jepet pronësia e shufrave të arit nëse pronari nuk i pretendon ato brenda gjashtë muajve.




Gravura e rrallë- Cheryl Conroy Warren, një ish-pronar i dyqaneve antike nga Milford, Connecticut, kohët e fundit gjeti një gravurë që më përpara i përkiste babait të saj. Fillimisht ai besoi se gravura nuk kishte asnjë vlerë, por më pas zbuloi se ajo ishte një punë e vitit 1951 nga artisti legjendar kinez-francez Zao Wou-Ki. Gravura u shit për 15 mijë dollarë.



Armët amtare amerikane- Kjo armë u përdor nga amerikanët vendas për të gjuajtur dhe për të bërë betejë me fiset e tjera vendase të Amerikës. Një amerikan e nxori këtë lloj arme në shitje dhe kapi vlerën e 102 mijë dollarëve. Ajo u gjet nga gjyshi i tij në një banjo, dekada më parë. Burri besonte se kjo armë kishte vlerë, por jo kaq shumë. Një shembull veçanërisht mahnitës i zejtarisë Otoo, ku arma ishte i gdhendur nga një copë arë dhe përmban 178 copëza bronzi.

Kukull e shekullit XIX- Një entuziaste lodrash nga Rhode Island e gjeti këtë kukull të shekullit XIX në një grumbull mbeturinash lokale, diku gjatë mesit të viteve 1990. Në vitin 2014, burri i zonjës, i cili ishte i ve kohët e fundit, vendosi të shihte nëse kukulla, vlente ndonjë gjë. Ai e çoi atë për vlerësim. Për habitje të këtij njeriu, vlerësuesi e informoi atë se objekti ishte në të vërtetë një kukull lecke e pikturuar me dorë, e punuar rreth 1860 Pas shumë kohësh, ajo doli në ankand dhe u shit për 14.200 dollarë.



Kartelat e bejsbollit milionëshe- Në vitin 2016, një familje nga SH.B.A. e jugut, të cilët kanë zgjedhur të mbeten anonimë, po shoshitnin nëpër sendet e stërgjyshërve të vonë, dhe hasën në një qese letre të vjetër, për të cilën supozuan se ishte e mbushur me plehra. Qesja ishte e destinuar për tek plehrat, por njëri prej anëtarëve të familjes kontrolloi përmbajtjen para se ta zinte dhe nxori shtatë kartona bejsbolli Ty Cobb, së bashku me disa kartolina dhe letra të vjetra. Familja kishte një nocion të paqartë se kartat mund të vlenin diçka. Të quajtura 'The Lucky Seven Find', kartat ultra të rralla datojnë nga fillimi i viteve 1900 dhe kanë vlerë më shumë se 1 milion dollarë.

E rrallë

Foshnja ngjante me alien, nëna tmerrohet nga ekoja e bebes

Sophie Scott është tmerruar kur një "alien" u shfaq në ekon e bebes së saj. Gëzimi i saj për të sjell në jetë një vajzë të vogël të shëndetshme u kthye në panik kur partneri Stephen Roberts i ka thënë se imazhi i marrë nga ekoja, i ngjante një krijese aliene.

Stephen dhe Sophie ishin të sigurt që mjekët nuk e kishin kuptuar që ishin binjakë. "Mund të shihnim një palë sy të tjerë përtej bebes dhe koka kishte formën e një alieni", ka thënë studentja 16-vjeçare nga South Shields, Angli. Pavarësisht se bënin shaka në



lidhje me imazhin e shfaqur në eko, çifti ishte i frikësuar. Por katër javë më vonë, ekoja kishte treguar një vajzë të vogël të shëndetshme.

FOTO E DITES

Liderët e shtatë vendeve më të industrializuara kanë realizuar fotografi të ndryshme gjatë Samitit të G7-s në Francë.



E jashtëzakonshme

Çifti gjen thesarin e pabesueshëm që vlen 5 milionë paund

Një çift që merret me zbulimin e metaleve, ka gjetur një nga depot më të mëdha të thesarit në historinë britanike, i cili besohet se vlen rreth 5 milionë paund. Adam Staples dhe partnerja e tij Lisa Grace zbuluan gati 2 600 monedha antike që

datojnë përpara 1 mijë viteve. Shumë prej monedhave janë në gjendje të mirë dhe mund të vlerësohen diku midis 1 000 dhe 5 000 paund secila. 2 571 monedhat e argjendit janë të përbëra nga pena e mbretit Harold II. Ekspertët thonë se



monedhat do të kishin qenë një shumë e konsiderueshme parash në atë kohë dhe i përkisnin një personi të rëndësishëm, të pasur, i cili ndoshta i varrosi për ruajtje.

BARSOLETA E DITËS



Dy shoqe:
 - Çfarë maskulli do të dëshiroje ta merresh për burrë?
 - Duhet të ketë kohë për mua, mos të jetojë me prindër dhe të ketë të ardhura të rregullta!
 - Tjetër?
 - Të mos më tradhtoj.
 - D.m.th, pensionist!




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30
The Angry Birds Movie 2 (3D)

Animuar/Aventurë/Komedi; 1 orë 39 min
 Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj, etj.

Regjia: Thurop Van Orman



Në ora 17:30

GOOD BOYS

Aventurë/Komedi; 1 orë 29 min

Rolet: Jacob Tremblay, Keith L. Williams, Brady Noon, Molly Gordon, Lil Rel Howery, Will Forte, etj.

Regjia: Gene Stupnitsky




Çdo ditë në ora 19:15

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
 Regjia: David Leitch




Çdo natë në ora 21:30

ONCE UPON A TIME IN HOLLYWOOD

Komedi/Dramë; 2 orë 41 min

Rolet: Leonardo DiCaprio, Brad Pitt, Margot Robbie, Al Pacino, etj.

Regjia: Quentin Tarantino




Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.



DASHI
 Sot do të bëni zgjedhje që shkojnë ndesh me ato që vendosni zakonisht. Do të rezultojnë mjaft produktive.



DEMI
 Këtë ditë doni të merrni përgjegjësi të reja mbi vetë. Planet tuaja do t'i konsultoni me partnerin.



BINJAKËT
 Sot do t'ju shoqërojnë gjatë ditës tuaj persona të gëzueshëm dhe mjaft të vendosur.



GAFORRJA
 Instikti juaj ju çon drejt një drejtimi që nuk ishte destinacioni juaj parësor. Gjithsesi është më i miri.



LUANI
 Sot mjafton të ndani mirë oraret e ditës dhe çdo gjë do t'ju shkojë siç dëshironi. Parteri ka një kërkesë për ju.



VIRGJËRËSHA
 Objektivat e ditës suaj përqendrohen vetëm tek puna. Mos harroni që dhe familja ka të njëjtën rëndësi.



PESHORJA
 Ditën e sotme duhet të gjeni aleatë të fuqishëm për të mbrojtur një projekt që ka kundërshtitë e veta.



AKREPI
 Nëse doni të merrni në dorë fatin tuaj sot mundohuni të qartësoni disa situata të dyshimta.



SHIGJETARI
 Në ditët e shkuara keni bërë një gabim që do t'ju duhet pak kohë për ta rikuperuar. Gjithsesi do të dini si të veproni.



BRICJAPI
 Sot një çështje financiare do t'ju shkaktojë shumë stres. Nëse ju kap paniku nuk do të arrini të zgjidhni gjë.



UJORI
 Nëse keni mundësi për të mbaruar punë sot mos e neglizhoni. Koha nuk ju premtonte për të gjitha projektet tuaja.



PESHQIT
 Keni lajme të bukura që doni t'i ndani më të gjithë. Do të gjeni disponibilitetin e personave që ju duan dhe ju mbështesin.

Stormzy ndahet nga e dashura



Reperi Stormzy është ndarë nga e dashura e tij, Maya Jama, pas katër vjetësh së bashku. Spekulumet lidhur me ndarjen e tyre kishin qarkulluar më herët gjatë javës së kaluar dhe ishte raportuar që muzikanti dhe e dashura e tij i kishin dhënë fund lidhjes shkaku i


karrierës. "Po mund ta konfirmoj që lidhja ka marrë fund dhe Maya është ndarë nga Stormzy", ka thënë përfaqësuesi i prezantueses televizive. Ndarja e tyre ka ardhur vetëm pak ditë pasi Stormzy kishte qenë i pranishëm në ditëlindjen e 25-të të Jamas.

E dashura e Ronaldos: Nuk është e lehtë të jetosh me një të famshëm!




Georgina Rodriguez ka qenë në një lidhje me futbollistin më të famshëm, që prej vitit 2016. Georgina, e dashura e Cristiano Ronaldos ka pranuar se nuk është "aspak e lehtë" të jetosh

në një lidhje me dikë aq të famshëm sa ai, por ajo ka theksuar se nuk do të ndryshonte asgjë. 25-vjeçarja ka rrëfyer se ishte "dashuri me shikim të parë" kur ata u takuan me Ronaldon.



Luana Vjollca mahnit me linjat e saj perfekte

Luana Vjollca është një nga moderatoret bukuroshe të ekranit shqiptar. Ajo gjithashtu është tejet aktive në rrjetet sociale, ku shpesh publikon fotografi ku dalin në pah linjat e saj perfekte. Ajo së fundmi ka publikuar një set fotografik ku shfaqet e jashtëzakonshme me format e saj fizike. Nuk kanë munguar komentet e shumta nga ndjekësit në "Instagram", krahas fotove që ajo ka publikuar së fundmi. Luana është një nga femrat e shoubizit shqiptar më të ndjekura në "Instagram", ku numëron mbi 1 milion ndjekës.



Çifti Beckham shfaqen të dashuruar në publik

Ish-futbollisti anglez David Beckham është shfaqur mjaft i dashuruar përkrah bashkëshortes së tij, Victoria Beckham, teksa po relaksoheshin në jahtin e Elton Johnit. Ata kanë kaluar kohë bashkë me fëmijët e tyre, Brooklyn, Romeo, Cruz dhe Harper në jug të Francës. Në një moment, paparacët kanë shprehur një fotografi ku ish-lojtari i Manchester Unitedit dhe Real Madridit e ka puthur gruan e tij, duke ndarë të qeshura me të.



INTERVISTA

Mario Vargas Llosa: Populli që nuk lexon, manipulohet lehtë



Mario Vargas Llosa jeton pas mureve të larta në një lagje pasanikësh në veri të Madridit. Fqinj të tij janë ambasadorët e Kuvajtit, Algjerisë dhe Venezuelës. Hapet një portë e rëndë, një roje hap derën e vilës së madhe dhe na prin drejt bibliotekës. Në dysheme një qilim persian, në dritare perde të gjelbra kadifeje, në tavolinën e divanit një arkë druri me puro. Mbi oxhak qëndron e varur një pikurë në vaj, e cila paraqet partneren e Vargas Llosas, Isabel Preysler, e cila rrjedh nga Filipinet dhe quhet "la perla de Manila". Ajo është ish-gruaja e Julio Iglesias, Enrique Iglesias është djali i saj. Peruani Mario Vargas Llosa (83) është njëri nga shkrimtarët më rëndësishëm të gjallë, ndër veprat më të njohura të tij janë "Shtëpia e gjelbër", "Tezja Julia dhe shkrimtari" dhe "Festa e çjapit"; më 2010 mori çmimin Nobel për Letërsi. Libri i tij më i ri "Thirrja e hordhive" është një autobiografi intelektuale e tij.

Das Magazin: Zoti Vargas Llosa, njëherë keni thënë se nëse nuk do të mund të shkruani, do t'ia shkrepnit vetes një plumb në kokë.

Kjo është e vërteta e plotë. Nëse nuk do të mund të shkruaja, moti do e kisha vrarë veten.

Das Magazin: Shkruani ende me të njëjtin pasion?

Gjithmonë. Të shkruash është mënyrë e jetës. Jeta ime sillet rreth punës sime si shkrimtar. Hulujtoq shumë, përherë - jo patjetër për të pasqyruar të vërtetën historike, këtu i lejoj vetes shumë liri, por që të kem mundësi të identifikohem me epokën dhe me karakteret.

Das Magazin: Philipp Roth ka thënë se në moshë të shtyrë s'k ishte për çfarë të shkruante më... Unë jam ndryshe. Do të vdisja nëse nuk do të mund të jetësoja së paku një të dhjetën e projekteve letrare që i kam në kokë. Këto janë edhe së paku dhjetë libra.

Das Magazin: Ju jeni i mbijetuar i fundit i gjeneratës së shkrimtarëve të mëdhenj latinoamerikanë. Po, gjenerata "Boom"?

Das Magazin: Gabriel García Márquez nga Kolumbia, José Donoso nga Kili, Julio Cortázar nga Argjentina, Carlos Fuentes nga Meksika.

Është një privilegj të jesh i mbijetuar i fundit, por ashtu është. Shumë miq kanë vdekur.

Das Magazin: Ju mungojnë?

Le të themi kështu: ishte një kohë e bukur, një epokë, kur Europa, SHBA-të, madje mbarë bota zbuloi letërsinë e Amerikës Latine. Në të vërtetë ajo ka ekzistuar

qëmoti, por ka qenë e mbyllur. Nuk e braktiste Amerikën Latine. Befas, nga fundi i viteve '50, fillimi i viteve '60, ndodhi zbulimi i letërsisë latinoamerikane. Edhe Amerika Latine filloi t'i rizbulojë dhe lexojë autorët e vet si për shembull Jorge Borges.

Das Magazin: Çfarë mendoni kur thoni: Amerika Latine filloi t'i lexojë autorët e vet?

Zbuluam se kemi një identitet të përbashkët latinoamerikan. Kur jetoja në Peru, nuk njihja asnjë autor në Kolumbi, Ekuador, Kili, përveç ndoshta Pablo Nerudës. Nuk kishim haber se çka domethënë të jesh latinoamerikan. Për herë të parë jam ndier i tillë kur jetoja në Paris. Atje fillova të lexojë letërsi latinoamerikane. Ishte inspiruese të shohësh: ne që rrjedhim nga Meksika, Argjentina, Peruja kemi rrënjët e ngjashme.

Das Magazin: Por juve nuk ju mungon Gabriel García Márquez?

Miqësia jonë mori fund për shkak të mospajtimeve politike. Aty filluan ndarjet, grindjet. Por e vërteta është kjo: ka ekzistuar përherë një miqësi që i mbijetonte këto mospajtime politike.

Das Magazin: Cilët janë zërat e rinj të letërsisë së Amerikës Latine?

Për shembull peruani Alonso Cueto. Ai është autori shumë interesant, por edhe reprezentativ, sepse ai, si shumë shkrimtarë latinoamerikanë, nuk është më provincial. Të rinjtë nuk kufizohen më në vendin e tyre. Kjo i ka sjellë letërsisë latinoamerikane një horizont shumë më ndërkombëtar. Kjo është e kundërta me jetën politike, e cila ka mbetur e kufizuar siç ka qenë gjithmonë.

Das Magazin: Çfarë po lexoni momentalisht?

I lexoj klasikët, vazhdimisht. Në moshën time të shtyrë i lexoj ata që më kanë iluminuar: Flaubert, Faulkner, madje edhe Sartre, prej të cilit jam distancuar, por ka ekzistuar një kohë kur Sartre kishte shumë ndikim ndaj meje. Sot kemi qasje ndaj shumë shkrimtarëve interesantë, në të gjitha vendet, atëherë nuk e kemi pasur këtë mundësi. Numri i shkrimtarëve të rinj është shumëfishuar, andaj është e vështirë t'i përcjellim të gjithë.

Das Magazin: Sartre ka thënë se shkrimtari mund të ndikojë ndaj historisë. A ia keni arritur ju?

Kjo është vështirë të matet. Por besoj se letërsia ndikon ndaj njerëzve dhe ka impakt politik. Pa dyshim.

Das Magazin: Edhe sot?

Për këtë jam i bindur. Por në jetën moderne kjo është më e vështirë. Letërsia është bërë dytësore -

muzika, filmi, interneti kanë ndikim më të madh. Letërsia është shtyrë në qoshe. Për fat të keq sot idetë janë më pak të rëndësishme se pamjet. Ne kemi një kulturë të ekranit.

Das Magazin: A është kjo mirë apo keq?

Një shoqëri e lexuesve është më e lirë dhe më kritike. Efekti i letërsisë është t'i bëjë njerëzit krijesa kritike. Një popull që nuk lexon manipulohet shumë më lehtë. Lexuesit e mirë janë rebelë, në kuptimin politik, fetar, seksual. Letërsia nuk është vetëm argëtim. E qartë, të lexosh Shakespeare është zbatimëse, Cervantes, Goethe, Thomas Mann, të mrekullueshëm. Por përtej kënaqësisë ne përfitojmë më shumë: idenë se krahas jetës sonë ka edhe jetë të tjera, të cilat janë më intensive, më të begatshme. Kjo krijon brenda nesh një lloj rebelizmi ndaj realitetit.

Das Magazin: Paskeni një dhomë madhështore të punës. A keni rregulluar vetë?

Jo. Kjo është vështirë të shpjegohet... Është dhoma ime e punës, por i takonte ish-burrin të gruas sime. Ai ka qenë ministër i ekonomisë nën kryeministrin Felipe González. Krejt këto libra janë të tij. Ai ka qenë intelektual. Këtu keni një mur të tërë me libra për astronominë, atje për matematikën, atje përpara ciceronë turistike - dhe një mur i tërë mbi Egjiptin e lashtë.

Das Magazin: Jeni 83-vjeçar. E kujtoni shpesh të shkruarën?

Disa epoka të caktuara dhe ngjarje i kujtoj me nostalgji, por nuk jetoj në të kaluarën, fare dhe aspak. E dua shumë të tashmen, shpesh me mendime futem në të ardhmen. Hombre, moshë i bën njerëzit më të mençur, mëson të dallosh çka është e rëndësishme dhe çka jo, çka është e thellë dhe çka është sipërfaqësore. Ky është thesari i neve pleqve.

Das Magazin: Cili është sukcesi juaj më i madh si shkrimtar?

Që unë shkruaj. E kam zgjedhur këtë profesion kur ka qenë shumë vështirë. Atëbotë kush kishte vokacion letrar, dëbohej diku në periferi të shoqërisë. Ishte e pashpresë të jetoje nga të

shkruarit. As që mund të merrej me mend. Babai im u alarmua tej mase kur zbuloi se po shkruaja poezi.

Das Magazin: Babai juaj ju ka rrahur. Dhe ju ka dërguar në Akademinë Ushtarake për t'ua flakur tej dëshirën për të shkruar. Ky është materiali i romanit tuaj të parë.

Atij ia merrte mendja se shkrimi është bileta e sigurt drejt dështimit. Të mos fitosh kurrë para, të bësh jetë bohemi - kështu e shihnte babai im jetën e shkrimtarit. Sot të rinjtë që duan të shkruajnë e kanë shumë më lehtë. Në kohën time të shkruarit ka qenë diçka për avokatë, arsimtarë apo profesorë gjatë ditës së diele. Askush nuk ia kushtonte jetën e tij shkrimit.

Das Magazin: Ç'rëndësi ka për ju çmimi Nobel?

Hombre, çmimi Nobel është lotari. Disa që e kanë fituar, e kanë merituar. Të tjerët që e kanë merituar, nuk e kanë marrë.

Das Magazin: A keni pësuar humbje gjatë jetës suaj?

Gjithsesi, shumë dështime, shumë gabime, shumë humbje. Njeriu nuk i kujton me qejf dështimet, është më e shëndetshme të mos i hapësh plagët e vjetra. Por unë kam bërë shumë gabime. Disa jam përpjekur t'i korrigjojë, të tjerat jam përpjekur t'i harrojë.

Das Magazin: Nuk dëshironi të përmendni asnjë?

Hombre, kam qenë komunist. Një gabim trashanik, një rrugë e gabuar! Në të vërtetë kam qenë anëtar i partisë vetëm një vit, sepse stalinizmi ka qenë aq sektar, aq fanatik, sa që e kam duruar vetëm një vit. Por shumë gjatë kam menduar se për njerëzimin marksizmi, komunizmi radikal, do të ishte rrugëdalje nga të gjitha padrejtësitë.

Das Magazin: Cili ka qenë më konkretisht gabimi juaj?

Që kam besuar në komunizëm. Që ky ka qenë gabim i madh, kjo shihet në dështimin total të shoqërive komuniste. Libri im më i ri - "Thirrja e hordhive" - është gjithsesi autobiografik. Bën fjalë për atë se si e kam zbuluar demokracinë, liberalizmin në

bazë të përvojave shumë konkrete dhe autorëve të rëndësishëm, nga Adam Smith, Karl Popper e deri te Friedrich August von Hayek. Ka qenë një proces personal: dalje nga kolektivizmi në një shoqëri të lirë, demokratike, në shtetin ku sundon ligji. Koha na dha të drejtë: shpërbërja e Bashkimit Sovjetik, zhvillimi i Kinës në shtet kapitalist, ndonëse ka mbetur diktaturë. Shiko çfarë po ndodhë në Venezuelë. Sa tragjike, sa e dhimbshme. Një vend aq i pasur - dhe gjithçka e rënuar.

Das Magazin: Çfarë u kujtohet nga takimi me Fidel Castron?

Kam zhvilluar vetëm një bisedë të gjatë me Castron. Si gjithë gjenerata ime edhe unë kam pasur entuziazëm të madh për komunizmin kuban, ai më dukej si përjetim transcendental. Deri kur pësoi kolaps.

Das Magazin: Si erdhi deri aty?

Shkaktar ishte rasti Padilla. Heberto Padilla ishte poet, i cili la poezinë për t'iu bashkuar revolucionit. U bë ministër, ishte krejtësisht i ndershëm. Pastaj u bë i padëshirueshëm, vetëm për shkak se e kritikoi pak politikën ndaj kulturës, nuk e kritikoi revolucionin. Por Castro e futi në hapsanë dhe e akuzoi se punonte për CIA. Çfarë marrëzie. Ne protestuam.

Protestuan shumë intelektualë të majtë. Susan Sontag, Julio Cortázar, Carlos Fuentes, Hans Magnus Enzensberger.

Llosa: Ishte një thyerje e madhe. Deri atëherë intelektualët e botës kishin përkrahur Kubën. Ata në Kubë shihnin një komunizëm demokratik. Shumë prej nesh u desh ta pranionim se kjo nuk ishte e vërtetë.

Das Magazin: A ishte kjo kthesa intelektuale në jetën tuaj?

Po, ishte kthesë. Por edhe më herët kishte indikacione. Kur në Kubë krijuan UMAP-in, Unidades Militares de Ayuda a la Producción. Në të vërtetë bëhej fjalë për kampe përqendrimi, ku mbaheshin kundërrevolucionarë, kriminelë dhe homoseksualë. Kam njohur shumë homoseksualë, revolucionarë, poetë, piktorë, valltarë, grupin El Puente. Vuanin shumë, futeshin në kampe, disa vranë veten.

Das Magazin: Si është gjendja e botës në vitin 2019?

Dua ta citoj Popperin. Më 1994, pak muaj para vdekjes, ai erdhi në Spanjë. Në një konferencë për shtyp gazetarët thanë: bota i ka punët keq. Ai tha: po, bota i ka punët keq, ka dhunë, shumë varfëri, mijëra probleme. Por përherë kur besoni se bota i ka punët keq, mendoni se kurrë gjatë historisë së njerëzimit nuk kemi qenë më mirë. Kurrë. Kjo duhet të na inkurajojë. Përgjigjja e tij është absolutisht e saktë.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

Topalli: Pas Feronikelit radhën e ka Llapit

Jetmir Topalli ka thënë për "Epokën e re" se pas Feronikelit radhën për humbje e ka skuadra e Llapit. "Fitorja ndaj Feronikelit do të thotë shumë për ne, njëherësh duhet të qëndrojmë me këmbë në tokë dhe në mënyrë të njëjtë të punojmë për ndeshjet e radhës. Kundër Llapit duhet të shkojmë me vetëbesim të plotë dhe ta japim maksimumin që t'i marrim pikët maksimale dhe ta vazhdojmë këtë ritëm edhe në ndeshjet e ardhshme", ka thënë Topalli



Suharekës", ka shtuar ai. Nga dy ndeshjet e zhvilluara, Ballkani ka marrë katër pikë dhe së bashku me Trepçën '89 e ndajnë pozitën e parë në IPKO Superligën e Kosovës në futboll.

**Batatina paralajmëron
5 000 shikues
ndaj Ballkanit**

Trajneri i Llapit, Tahir Batatina, nëpërmjet një postimi në "Facebook" ka thënë se 5 000 shikues do të jenë të pranishëm në ndeshjen ndaj Ballkanit. "Stadiumi 'Zahir Pajaziti', i gatshëm për ndeshjen e së shtunës ndaj Ballkanit për të gjithë tifozët llapjanë dhe 'Legjendat'. I presim jo më pak se 5 000 shikues në stadiumin 'Zahir Pajaziti', ka shkruar Batatina. Duket se ky paralajmërim i trajnerit llapjan vjen për ta trembur skuadrën kundërshtarë pas humbjes që pësoi Llapi nga Drenica dhe fitores së arritur nga Ballkani ndaj Feronikelit.

EPOKA E RE**Veton ZYMBERI**

PRISHTINË, 26 GUSHT - Skuadra e Ballkanit e ka mposhtur bindshëm kampionin në fuqi të Kosovës në futboll, Feronikelin (3-1) dhe në këtë mënyrë ka konfirmuar forcën që e ka në këtë edicion garash. Sulmuesi i skuadrës që drejtohet nga trajneri Ismet Munishi, Jetmir Topalli, ka thënë se fitorja ndaj "Niklit" ka qenë e vështirë, por edhe e pritshme. "Normalisht se është një fitore shumë e rëndë-

sishme për klubin tonë, por ishte edhe e vështirë për t'u arritur. Ne kemi besuar dhe jemi përgatitur maksimalisht për këtë ndeshje dhe në fund ia arritëm qëllimit", ka deklaruar Topalli për gazetën. Kjo fitore e ka trimëruar mjaft shumë sulmuesin Jetmir Topalli, i cili beson se skuadra e tij mund t'i marrë edhe tri pikë edhe në ndeshjen e xhiros së tretë ndaj Llapit, ani pse ndeshja do të zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë. "Fitorja ndaj Feronikelit do të thotë shumë për ne, por duhet të qëndrojmë

me këmbë në tokë dhe në mënyrë të njëjtë të punojmë për ndeshjet e radhës. Kundër Llapit duhet të shkojmë me vetëbesim të plotë dhe ta japim maksimumin që t'i marrim pikët maksimale dhe të vazhdojmë këtë ritëm edhe në ndeshjet e ardhshme", ka thënë Topalli.

Skuadra e Ballkanit në opinionin sportiv vlerësohet si një nga kan-

didatet kryesore për ta fituar titullin e kampiones sikurse që konsiderohet favorite edhe në garën për Kupë. I pyetur nga gazeta se a synon me çdo kusht Ballkani njërin nga këta trofe, Topalli ka dhënë një përgjigjeje diplomatike, duke mos treguar synimet e klubit nga Suhareka. "Ballkani ka për qëllim ta përfaqësojë sa më denjësisht klubin dhe qytetin e

Majlinda, e bronzte në Japoni

PRISHTINË, 26 GUSHT - Kosova e ka fituar edhe medaljen e dytë të bronzte në Kampionatin Botëror të Xhudos i cili po mbahet në Japoni. Të dielën medaljen e parë të bronzte Kosovës ia siguroi Distria Krasniqi, kurse të hënën të bronztën e fitoi edhe Majlinda Kelmendi.

Kampionia olimpikë fillimisht e mposhti Perenc Agata nga Polonia. Në çerekfinale e mposhti japonezen Ai Shishmime, por në gjysmëfinale Kelmendi pësoi humbje nga kampionia botërore, Abe Uta. Pavarësisht prej kësaj humbje, Majlinda Kelmendi nuk u ndal dhe arriti fitore në garë për medaljen e bronzte ndaj portugezes Joana Ramos. Trajneri i Majlindës, Driton Kuka, e ka quajtur këtë ditë të mrekullueshme për sportin e Kosovës dhe mbarë popullin shqiptar. "Ditë e mrekullueshme për sportin e Kosovës dhe mbarë popullin shqiptar



kudo që gjendet. Medalja e dytë vjen nga Botërori në Tokio. Tetët minuta, me ritëm të çmendur të Majlindës në gjysmëfinale kundër japonezes së dytë që u takua sot, nuk mjaftuan që japonezes, që krejt kohën i iku luftës, të penalizohet për herë të tretë që do ta sillte fitoren!

Majlinda fiton medaljen e tretë në kampionate botërore. Krenaria ime po rritet me ju nxënësit e mi. Çdo minutë të punës sime me ju e paçi hallall tërë jetën!", ka shkruar Kuka. Në Tokio do të garojnë edhe Akil Gjakova, Nora Gjakova dhe Loriana Kuka.

'Dardanët' sonte hapin 'Fan-Club'-in

PRISHTINË, 26 GUSHT - Grupi i tifozëve të Kosovës, "Dardanët", sonte (e martë) do ta bëjnë hapjen solemne të "Fan-Club"-it të tyre. Baza e tyre tani do të jetë përballë Fabrikës së Tjegullave në Prishtinë. "Ju ftojme në hapjen solemne të 'Fan Club Dardanët'. Ejani ta festojmë së bashku hapjen e klubit të

'Dardanëve', vendtakimin e ardhshëm të të gjithë tifozëve të Kosovës, një hapësirë multifunkionale për shoqërim, punë dhe shikimin e përbashkët të ndeshjeve sportive. Të martën, më 27 gusht, ora 20:00. Lokacioni: përballë Fabrikës së Tjegullave, Prishtinë", thuhet në njoftimin e "Dardanëve".



Gjilani në shtator zhvillon miqësore me Schaffhausenin

GJILAN, 26 GUSHT - Skuadra e Superligës së Kosovës në futboll, Gjilani, do të zhvillojë ndeshje miqësore në muajin shtator ndaj skuadrës nga Liga e Dytë zvic-

ane, FC Schaffhausen. Ndeshja në mes të skuadrës vendase të Schaffhausenit dhe asaj udhëuese të Gjilanit do të zhvillohet në stadiumin "Lipo Park", në

qytetin kufitar të Schaffhausenit, me fillim nga ora 16:00. "Ndeshja miqësore mes skuadrave të lartcekura zhvillohet më 8 shtator, datë kjo e cila dërgon kampionatet

evropiane në pauzë për shkak të angazhimeve të përfaqësuesve në kuadër të kualifikimeve të 'Euro 2020', thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit.




Verstappen: Botërori në Formula 1 është i mbyllur

HASSELT, 26 GUSHT - "Është shumë e vështirë ta rihapim botërorin e Formula 1. Kjo vlen edhe për mua. Që të ndodhë kjo gjë, duhet që Hamiltoni të jetë piloti më i pafat në botë në pjesën e dytë të sezonit", u shpreh Max

Verstappen për "Telegraaf". Piloti holandez i Red Bullit shprehet se ka hequr dorë nga titulli kampion këtë vit. Ai konfirmon se makina austriake ka nisur që tani punën për 2020-n. "Po punojmë që t'i ngushtojmë

dallimet me Mercedesin, ndërkohë që sinjalet e marra janë pozitive. Me motorin Honda kemi mundësi ende të përmirësohemi. Unë dua të fitoj, nuk më intereson të dal i dyti", ka thënë Verstappen. Gara e radhës e Botërorit të

Formulës 1 është në Belgjikë. "SPA është pista ime e preferuar. Është gjithnjë kënaqësi kur pilotoj aty. Këtë herë tifozët e mi do të kenë një tribunë speciale, që do ta ngjyrosin me portokalli", ka deklaruar Verstappen.



Trepça '89 akuzon Vushtrrinë dhe gjyqtarin Vula

MITROVICE, 26 GUSHT - Pavarësisht se nuk kishin dhënë vërejtje në raportin zyrtar të ndeshjes, drejtuesit e KF Trepça '89 përmes një kumtese për media kanë reaguar ashpër në lidhje me organizimin e dobët të ndeshjes së dytë kampionale ndaj Vushtrrisë dhe ndarjen e drejtësisë. "Edhe pse pas ndeshjes së zhvilluar më datën 25 gusht, e vlefshme për javën e dytë të IPKO Superligës së Kosovës ndërmjet FC Vushtrria - KF Trepça '89, e cila përfundoi me rezultat të barabartë 1:1, ne si kryesi dolëm me deklaratë zyrtare se ndeshja ishte mirë e organizuar nga vendasit, detyrohemi që përmes kësaj deklaratë të reagojmë në raportin vlerësues nga personat zyrtarë, në këtë rast Senad Hamgjiq, i cili nuk e dimë se për interesa të kujt e vlerëson ndeshjen me notën pozitive 5 (pesë). Si dëshmi janë incizimet në pesëmbëdhjetë minutat e fundit kur lojtari Muja ndalet në mënyrë të palejueshme dhe referi akordon goditje dënimi, atëherë fillojnë gjuajtjet e më shumë se dhjetë shisheve e gjësente të tjera të rrezikshme në fushë, dëshmi kur njëri nga këto shishe njëri prej lojtarëve të FC Vushtrrisë e hap dhe pinë nga ajo shishe (qesharake, por e rrezikshme gjuajtja)", thuhet në reagimin e Trepçës '89. "Referi kryesor Vula ka bërë gabim trashanik kur



nuk e ndëshkon me karton të kuq Ilir Izmakun pas ndërhyrjes në minutën e 49, por jo vetëm për këtë ndërhyrje Izmakun gjatë gjithë ndeshjes ka reaguar në mënyrë të çuditshme ku herë pas here edhe ka goditur lojtarët tanë pa top. Ka pasur edhe ndërhyrje të tjera nga lojtarët vendas që i kanë merituar së paku tre kartonë të kuq, por referimi skandaloz i Vulës, i cili, si

duket, ka planifikuar që ekipi vendas të dalë i pamposhtur, pse jo edhe ta fitojë ndeshjen", thuhet në reagimin e '89-sht. Skuadra nga Mitrovica vlerëson se me lëshime joprofesionale dhe sjellje të tilla të adhuruesve futbollit i Kosovës nuk shkon përpara. Kjo skuadër ka kërkuar kujdes më të madh pasi vëzhgimi është në çdo ndeshje nga UEFA dhe FIFA.

Wilderi synon përballje me Joshuan në Britaninë e Madhe

LAS VEGAS, 26 GUSHT - Boksieri amerikan Deontay Wilder ka deklaruar se në planet e tij është një duel në Britaninë e Madhe, por pa përmendur se ndaj kujt do ta zhvillojë atë. Gjithsesi, një përballje për unifikimin e titujve kampionë bote ndaj Anthony Joshua, nëse ky i fundit fiton revanshin ndaj Ruizit, duket se është objektivi kryesor i Wilderit. Dhe për ta realizuar këtë gjë është gati të udhëtojë e duelojë edhe në Angli. Amerikani mban titullin e kategorisë WBC dhe është vënë në shënjestër edhe nga Tyson Fury, që shprehet se do të duelojë mes tyre sërish më 22 shkurt, në Las Vegas. "Joshua duhet të kujdeset që të rikthehet kampion bote dhe më pas të diskutojmë sërish për një unifikim të titujve kampionë bote. Unë jam gati të vij të



dueloj në Angli. Kam qenë edhe më parë këtu, në vitin 2012, kur mposhta Audley Harrison", ka thënë Wilderi.

SHKURT

Sot fillon afati kalimtar në basketboll

Federata e Basketbollit e Kosovës ka njoftuar se sot (e martë) deri më 7 shtator do të jetë afati kalimtar për të gjitha grupmoshat si dhe paraqitja e lojtarëve të huaj. "Ju lutemi që për paraqitjen e lojtarëve t'i respektoni rregulloret mbi kalim dhe regjistrim të lojtarëve", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Gasperini lavdëron Etrit Berishën

Trajneri Gian Piero Gasperini e largoi Etrit Berishën nga Atalanta në momentin që u kualifikuan në Ligën e Kampionëve, duke e detyruar portierin shqiptar që të gjente një skuadër tjetër. Gardiani i Kombëtares shqiptare i tregoi edhe në përballjet direkte, atje ku Atalanta fitoi me rezultat 2-3 ndaj SPAL-it në transfertë. Këtë e ka pranuar edhe vetë Gasperini: "Etrit Berisha ishte më i miri në kampin kundërshtar. Si një 'ish', vërtet shumë e vështirë për ta kapërcyer. Gjithashtu, edhe Petanja, që ia njohim vlerat. Fituam një takim që e luajtëm ndaj dy futbollistëve që na njihnin aq mirë".

Griezmanni kopjon Messin dhe Jamesin

Antoine Griezmann dhuroi shfaqje të jashtëzakonshme teksa shënoi dy herë në fitoren 5-2 ndaj Real Betisit. 28-vjeçari zbuloi se si goli dhe festimi i tij erdhën nga frymëzimi i dy ikonave sportive, bashkëlojtarin e tij Lionel Messi dhe të shkëlqyerin e basketbollit LeBron James. "E shoh Leo duke e bërë atë në stërvitje dhe përpiqem ta kopjoj atë. Më pëlqen shumë rituali që LeBron bën dhe u përpoqa ta kopjoja", ka thënë Griezmanni.

PSG-ja në telashe, lëndohet Mbappe

PSG-ja ka mposhtur Toulousen me rezultatin 4-0, por duket se gëzimi nuk është ndjerë aspak në kampin parisien dhe kjo për shkak të lëndimeve të shumta. Në minutën e 66 të sfidës, Mbappe ka dalë nga fusha e lojës me lot në sy, pas tërheqjes muskulore që pësoi. Nuk bëhet ende me dije grada e lëndimit dhe sa do të mbetet jashtë, ylli francez. Pa Neymarin dhe me dëmtimin e Cavanit tashmë situata te PSG-ja është e rënduar.

Boatengu, afër Fenerbahçes

Mbrojtësi Jerome Boateng pritet të largohet shumë shpejt nga Bayern Muncheni, pasi e ka humbur vendin e titullarit. E përditshmja turke 'Hurriyet' raporton se Fenerbahçe është e interesuar për transferimin e Boatengut dhe dy klubet në fjalë janë duke diskutuar për transferimin e ish-reprezentuesit të Gjermanisë në kampionatin turk.

Calhanoglu larg Milanit, afër Torinos

Hakan Calhanoglu mund të largohet nga Milani në fund të merkatos. Mesfushori i cili është pjesë e kuqezinjve që nga viti 2017, kur u transferua nga Bayer Leverkuseni për shumën e 24 milionë eurove, pëlqehet shumë nga trajneri i skuadrës së Torinos, Walter Mazzarri. Klubi granata kërkon ta përforcojë repartin e mesfushës dhe turku i Milanit është objektivi kryesor i tyre. Torino ka filluar bisedimet me klubin nga "San Siro" për transferimin e Calhanoglu.



Autor: GAZMEND MORINA		ÇRREGULLIM MENDOR PROGRESIV	AFRUESH-MWRI, NGJASHMWRI	BARAZIM NW SHAH	KWNGWTARJA BUNJAKU ZUGER INFORMAT. TECHNIKER	GURRW (sh.shq.)	SUDOKU									
PARALIZA E LEHTW							8		2							1
								6		3	7					5
TW LUMTW							7	4								6
											4					
RI PESHOVA								3	8	5		9	7	1		
										8						
AKUZUES I SOKRATIT					BASHKWT. KULLW E XHAMISW		9						6			8
REKRUT NW PERANDORINË OTOMANE						NJË E NJËMIJTA PJESË E METRIT (pashq.)	4			1	9		2			
							8					6				9
ISH ATLETJA MERLIN					ILDA MARE E DREMITUR		EPOKA E RE		KOHW BRENDA SW CILWS DUHET TW KRYHET NJW PUNW	GANNA, ANGOLA	VENDLINDJA E ODISEUT	BREJTWS I VOGWL (shq.)				
SHTET NW AZI							REGJISORI ... SOPI SFOND SHKRONJASH									
KWNGWTARJA AMERIKANE NW FOTO	GJYSMËRR-ETH		KAFSHË E MADHE GRABITOQARE RESHAT ARBANA	BODRUMI I PIJEVE	KALW I STWRVITUR SHKRONJA TW NJWJTA	SHTETI QË KISHTË NË KRYE NJË KALIF DIPLOMATI NORVEGJEZ ... EIDE										
PWRJETWSI, AMSHIM (krah.)																
LLOJ PISTOLETE ME MULLI																
"A" para dy "R"			ZANORE KRIJUAR NJW ANIMACION		SHKRIMTARI ALI ... INSTITUTE VIDEOGRAPHY ONTARIO											
SKITAR																
"TUNIZIA"			SHTET FEDERAL NW SHBA BANORWT E NJW QYTETI TONW													
ZANORE		BIMW QW BWN KOKRRA TW THARA BISHW MALI (fem.)														
AKTORJA E NJOHUR MEKSİKANE ... HAYEK					LIMONTI	AKTORJA E NJOHUR ... COX ADNAN (perkdh.)										
AXHAMIU				VEPËR KU SHËNOHESHIN VIT PËR VIT NGJARJET MË TË RËNDËSISHME TË KOHËS												
					PASIMI (Sport) KUFOMË NJERIU E BALSAMOSUR											
BARKA E MADHE QË SHËRMBEN PËR TË MBARTUR MALLRA NËPËR LUMENJ	I HJUSHWM, TWRHQWS PJESA E NJË PËLHURË E THYER ME DYSH															
PRAPA			UGANDA, TAJVANI ZOMBIE RESEARCH SOCIETY		ISLANDA, LETONIA REOMIR, LITWR, ELEKTRON											
ZANORE		QYTET NW TURQI IDRIZ BALAJ				SHTET AZIATIK AKTORJA SUEDEZE MARGRET										
MASË E VËLLIMIT TË LËNGJEVE (shq.)						FRIKËSOJ SHUMË DIKË BASHKWT.										
AZEM BEJTA			KWNGA QW I KWNDOHET TË DASHURËS ME KITARW NWN DRITARE													

ZGJIDHJA E SUDOKU: KOJONA 1:389 265 471; KII:216 437 985; KIII:754 981 326; KIV:597 614 832; KV:638 529 714; KVI:142 873 689; KVII:971 352 648; KVIII:463 198 257; KIX:825 749 193. ANALE, LAG, TE, MAJNA, PASI, TAVAT, M, SHARMANT, PATET, PAS, UT, IL, MINOREN, A, IZMIR, IRAN, RENA, LITRI, LEMERIS, ZIT, AB, SERENADA, ANISA. ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: M, PAREZA, AFERIM, RI MATV, ANIT, I, NIZAM, OTI, IM, JEMENI, AGIM, AT, KALIFATI, AHRET, I KORITA, AU, NAGANT, ATEMATIK, ARR, O, ALIU, EL, LAK, SKIATOR, RETINA, A, A, KIKIRIK, RR, VOZA, SALMA, NIKI, TINO, I RIU,



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

Në pajtim me dispozitat e Ligjit për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligji nr. 03/L-149, neni 12, paragrafi 4, *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë shpall:*

Konkurs për "Marrëveshje për shërbime të veçanta"

Institucioni: *Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë*

Departamenti: Departamenti për IE koordinim të politikave dhe çështjeve ligjore

Paga bruto: 423.47 €

Titulli i vendit të punës: Zyrtar/e ligjor (1 vend pune)

Kohëzgjatja e kontratës: 6 muaj

Vendi i punës: Prishtinë **Datë:** 26.08.2019

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Hartimi i ligjeve dhe akteve nënligjore nga fushëveprimtaria e ministrisë përkatëse;
- Sigurimi i pajtueshmërisë së projektligjeve dhe të akteve të tjera nënligjore me Kornizën Kushtetuese dhe me legjislacionin në fuqi në Kosovë;
- Kryerja e formatizimit të ligjit, të revidimeve gjuhësore dhe ligjore, si dhe përkuqjesja që përmbajtja teknike e ligjit të jetë e saktë dhe identike në të tri gjuhët zyrtare;
- Përcjelljen dhe menaxhimin e procedurave për hartimin dhe dorëzimin e projektligjeve në Qeveri;
- Hartimi i kontratave, marrëveshjeve, vendimeve, memorandumeve dhe dhënia e këshillave ligjore;
- Bashkërendimi dhe ndërlidhja e punëve sipas nevojës me zyrtarët e tjerë të zyrës ligjore;
- Kryerja e të gjitha punëve të tjera të cilat i përcakton drejtori i departamentit.

Kualifikimet

- Diploma e Fakultetit Juridik,
- Së paku 1 vjet përvojë pune në legjislaturë.
- Përvoja si administrues ose menaxher është e dëshirueshme mirëpo me rëndësi më të vogël.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, të kenë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe aftësitë fizike që kërkojnë për pozitën përkatëse.

Data e mbylljes së konkursit: Konkursi mbetet i hapur 4 ditë kalendrike nga dita e publikimit në uebfaqen e MASHT-it dhe shtypin ditor. Data e mbylljes së konkursit 30.08.2019 .

Kandidatët aplikacionin (formularin për konkurrim) mund ta tërheqin në uebfaqen e MASHT-it <http://masht.rks-gov.net/>, ose ta marrin në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Rr. "Agim Ramadani" nr. 1 në zyrën e arkivit ku edhe i dorëzojnë aplikacionet e plotësuar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: Kopja e letërnjoftimit, kopjet e dokumentacionit të kualifikimit si dhe dokumentacione tjera të nevojshme sipas konkursit.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology

U skladu sa odredbama Zakona o civilnoj službi Republike Kosovo, Zakon br. 03/L-149, član 12, stav 4, *Ministarstvo obrazovanja nauke i tehnologije objavljuje :*

Konkurs "Sporazum o posebnim uslugama"

Institucija: *Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije ria*

Departament: Departament EI koordinaciju politike i pravna pitanja

Plata bruto: 423.47 €

Naziv radnog mesta: Pravni službenik/ca (1 radno mesto)

Vreme trajanja ugovor: 6 meseci

Radno mesto: Priština **Datum :** 26.08.2019

Zadaci i odgovornosti

- Izrada zakona i podzakonskih akata iz delokruga resornog ministarstva;
- Obezbeđivanje usaglađenosti nacрте zakona i drugih podzakonskih akata sa Ustavnim okvirom i zakonodavstvom na snazi na Kosovu;
- Izrada formatizacije zakona, jezička i pravna revidiranja, kao i posvećivanje pažnje da je tehnički sadržaj zakona tačan i identičan na sva tri službena jezika;
- Pracenje i menadziranje procedure za izradu i podnošenje nacрте zakona Vladi;
- Izrada ugovora, sporazuma, odluka o memoranduma i davanje pravnih saveta;
- Koordinacija i povezivanje poslova prema potrebi sa drugim zvaničnicima pravne kancelarije;
- Obavljanje svih drugih poslova koje odredi direktor departamenta.

Kvalifikacije

- Diploma Pravnog fakulteta,
- Najmanje 1 godine radnog iskustva u zakonodavstvu.
- Iskustvo kao administrator ili menadžer je poželjno ali manje bitno.

Uslovi za učešće na konkurs

Pravo na apliciranje imaju svi punoletni državljani Republike Kosovo koji imaju punu sposobnost da deluju, da imaju potrebno obrazovanje i stručnu sposobnost da obavljaju dužnosti i koji imaju fizičke veštine koje se zahtevaju za određenu poziciju.

Datum zatvaranje konkursa: Konkurs je otvoren 4 kalendarska dana od dana objavljivanja na web stranici MONT-a i dnevnoj štampi. Dan zatvaranje konkursa 30.08.2019

Kandidati aplikacije (obrazac za konkurisanje) mogu preuzeti na web stranici MONT-a <http://masht.rks-gov.net/> ili da dobiju u Ministarstvo obrazovanja, nauke i tehnologije, Ul. "Agim Ramadani" br. 1 u kancelariji arhive, gde takođe i dostavljaju popunjene aplikacije.

U prilog aplikacije morate priložiti: Kopija lične karte, kopija dokumentacija za kvalifikacije kao i ostala dokumenta potrebna u skladu sa konkursom.

Zahtevi poslati nakon isteka krajnjeg roka neće se primati Zbog velikog broja pristiglih prijava kontaktiraće se samo kandidati koji su ušli u uži izbor.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agencija za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Bazuar në nenin 8 pika 3.1, nenit 6 pika 5 dhe nenit 33 të Ligjit Nr.04/L-036 për Statistikat Zyrtare të Republikës së Kosovës, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2012 për kushtet dhe Mënyrën e Ofrimit të te Dhënave të Fituara me Përpunime të Veçanta të Statistikave Zyrtare si dhe nenit 12 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 03/ L -149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve, *Agjencia e Statistikave të Kosovës bënë:*

Shpalljen e Konkursit Publik për Marrëveshje për Shërbime të Veçanta

Emri i Institucionit	<i>Agjencia e Statistikave të Kosovës</i>
Titulli i punës:	Anketues/ Intervistues për Anketën e Fuqisë Punëtore (BE - AFP)
Numri i referencës:	ASK-DSS-001
Tarifa e shërbimit:	I negociuar
Raporton te:	Zyra rajonale dhe direkt te njësia e tregut të punës në ASK
Lloji i kontratës:	Marrëveshje për Shërbime të Veçanta-(MSHV)
Kohëzgjatja e kontratës:	Katër (4) muaj
Orari i punës:	I plotë
Lokacioni dhe numri i ckeikutuesve:	ASK - 2

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Të marrin pjesë në trajnime dhe të njihen me Udhëzimet Metodologjike dhe Organizative (Të dhënat bazike të anketës, Të dhëna karakteristike demografike të anëtarëve të ekonomisë familjare dhe Pyetësi Individual) dhe të jenë të përgatitur për të praktikuar në terren bazuar në udhëzimet për anketën BE-AFP;
- Të zhvillojnë grumbullimin e të dhënave për anketën e BE-AFP me metodologjinë CAPI (Laptop).
- Të bëjnë identifikimin e të gjithë anëtarëve të ekonomisë familjare duke intervistuar anëtarët që plotësojnë kriteret për moshën (në moshë 15 vjeç e lart të secilës ekonomi familjare);
- Të respektojnë udhëzimet e pyetësorit për pyetjet që nuk duhet t'i parashirojnë disa të anketuarve dhe të ndjekin të gjitha procedurat dhe sqarimet e përkrahura në udhëzime;
- Para largimit nga ekonomia familjare bënë kontrollimin e pyetësorit elektronik të plotësuar për t'u siguruar se të gjitha pyetjet janë plotësuar dhe të gjitha udhëzimet janë ndjekur;
- Rishqyrtimi për të intervistuar të anketuarit të cilët nuk mund të intervistohen gjatë vizitës së parë;
- Përdorimi i adresave dhe hartave për qarqet regjistruese dhe ekonomitë familjare të caktuara;
- Të njoftojnë mbikëqyrësit për problemet dhe pasiguritë e mundshme dhe kërkonin ndihmë nëse është e nevojshme;
- Intervista zhvillohet në gjuhën të cilën e flasin ai komunitet.
- Të bëjnë raportimin ditor të mbikëqyrësi (zyra rajonale);
- Të përfundojnë Anketa e Ekonomive Familjare brenda afatit.
- Të mbajnë të gjitha informatat e pranuar në familjet e anketuara si sekret zyrtar.
- Të kthejnë pajisjet e pranuar nga ASK (Laptopat), pas përfundimit të punës në terren.

Përgatitja shkollore/përvoja:

- Të kenë të kryer së paku shkollën e mesme.
- Të kenë përvojë në aplikimin e teknologjisë informative (laptopëve/tabletave)
- Përparësi kane kandidatet të cilët kanë kryer nivel më të lartë të shkollimit.
- Përparësi kanë personat që ndjekur kurse të teknologjisë informative apo që kanë marre pjesë së paku në një anketë me metodën CAPI.

Kompetenca dhe aftësitë:

- Aftësi dhe bashkëpunim shumë të mirë për të komunikuar;
- Të jenë të gatshëm për punë ekipore;
- Aftësi të orientimit në hapësirë (përdorimi i hartave në hapësirë për identifikimin e objekteve të banimit);
- Aftësi kompjuterike, Word, Excel, internet etj;
- Të ketë aftësi të mira organizative dhe të jetë i gatshëm të punoj nganjëherë me orë pune më të gjatë përfshi vikendet.
- Të jetë nga rajoni përkatës ku kërkohet të zhvillohet LFS.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Të drejtë aplikimi kanë të gjithë Qytetarët e Republikës së Kosovës të moshës madhore (mbi 18 vjet) të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësitë fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

Konkursi është i hapur 5 ditë kalendarike nga dita e publikimit në mjetet e informimit dhe në Web-faqen e ASK-së.

Numri i anketuesve për rajonin e Prishtinës:

Rajoni	Anketues shqiptarë
Prishtinë	2

Paraqitja e kërkesave: Formularët për aplikim mund të merren në Arkivin e ASK-së, ose mund të shkarkohet nga web faqja e ASK-së në adresën <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Agjencinë e Statistikave të Kosovës, Rr."Zenel Salihu" nr.4 Prishtinë.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten: CV¹, kopja e letërnjoftimit, dokumenti mbi vendbanimin, tema e diplomës apo vërtetimi nga viti i fundit i nivelit të shkollimit (të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje).

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Kërkesat e pakompletuara do të refuzohen.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

Aplikacionet të cilat dërgohen nëpërmjet postës do të konsiderohen të vlefshme të gjitha ato aplikime të cilat e mbajnë datën në dërgesën e dërguar deri në ditën e fundit të afatit të dorëzimit dhe do të konsiderohen nëse arrijnë brenda 3 ditëve, aplikacionet e pranuar pas këtij afati dhe aplikacionet jo të plota nuk do të pranohen.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të nënshtrohen intervistës me gojë.

Për informata të hollësishme, mund të kontaktoni në zyrën e personelit, në tel: 038- 200 31 149 apo 038-200 31 141 prej orës 08:00 – 16:00.

¹ Përfshirë: Nr. i telefonit si dhe një adrese elektronike

Kërkesa për shprehje të interesit

Emri i shkollës: **"Enver Haliti"**
Komuna: **Skenderaj**

Data: **27.08.2019**

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/109-CS/1.5	Trajnim: Bazat e bashkëpunimit online

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe "Enver Haliti" Lubovec, Skenderaj.

Objektivi i nën-komponentit 1.3. (GZSh) të projektit ESIP është forcimi i kapaciteteve të shkollave që financohen me fonde publike që t'i planifikojnë dhe t'i menaxhojnë burimet si dhe ta promovojnë angazhimin qytetar përmes pjesëmarrjes së mësimitdhënësve, prindërve dhe komunitetit në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e aktiviteteve të shkollës

Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi i shërbimeve të konsulentëve të nevojshme: Trajnim: **Bazat e bashkëpunimit online**

Kualifikimet e firmës konsulente:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve të natyrës së ngjashme;
- Përvojë në trajnimin për përdorimin e teknologjisë për mësimitdhënësve, personelin e shkollës apo kategori të tjera.
- Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.

Firmat konsulente të pranueshme do të vlerësohen dhe radhitën në listën e ngushtë në bazë të kërkesave kualifikuese si më lartë.

Firmat konsulente duhet të tregojnë se kanë në dispozicion staf profesional, përkatësisht trajnerë të certifikuar dhe me përvojë në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme.

Kriteret e vlerësimit:

- Përvoja e suksesshme në ekzekutimin dhe zbatimin e kontratave për ofrimin e shërbimeve të konsulentëve nga fusha e Teknologjisë (40%);
- Përvoja specifike në ofrimin e trajnimeve të natyrës së ngjashme (40%);
- Disponueshmëria e personelit kyç profesional të kualifikuar për detyrat (20%)

Procesi i seleksionimit:

Aktiviteti i prokurimit të do të realizohet në përputhje me: Udhëzime: përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga huamarrësit e Bankës Botërore" të muajit janar 2011 dhe të rishikuara në korrik të vitit 2014, dhe me dispozitat e përcaktuara në marrëveshjen për financim, sipas përzgjedhjes të bazuar në metodën e Kualifikimeve të Konsulentëve (KK).

Firmat konsulente të interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhura të aplikojnë me Shprehjet e tyre të Interesit për shërbime konsulente në adresën "Enver Haliti" Lubovec, Skenderaj, më së largu deri më datën; **04.09.2019**

Firmat e interesuara të konsulentëve mund të marrin informacion shtesë ose Termat e Referencës të detajuar për këto detyra në adresën e shënuar më poshtë.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues: Sami Bekteshi
Telefoni: 044/532-563
E-maili: bekteshisami@hotmail.com



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Zyra e Kryeministrit –Ured Premijera –Office of the Prime Minister
Agjencia e Statistikave të Kosovës - Agjencia za Statistiku Kosova - Kosovo
Agency of Statistics

Na osnovu člana 8. stava 3.1, člana 6, stava 5 i člana 33 Zakona br.04 / Z-036 o Zvaničnoj Statistici Republike Kosovo, Administrativnog Uputstva br.08/2012 o Uslovima i Načinu Pružanja Statističkih Podataka Dobijenih Posebnom Obradom Zvaničnih Statistika i člana 12 stava 4 Zakona br. 03 / Z-149 o Civilnoj Službi Republike Kosova, Zakona br.04/L-077 o Obligacionim Odnosima, *Agjencia za Statistiku Kosova*, raspisuje:

Javni Konkurs o Sporazumu za Posebne Usluge

Naziv institucije:	<i>Agjencia za Statistiku Kosova</i>
Naziv pozicije:	Anketar/Ispitivač za Anketu o Radnoj Snazi (EU - ARS)
Referentni broj:	ASK-OSS-001
Tarifa usluga:	Po dogovoru
Izveštava:	Regionalnoj Kancelariji i direktno jedinici za tržište rada u ASK
Vrsta ugovora:	Sporazum za Posebne Usluge-(SPU)
Trajanje ugovora:	Četiri (4) meseci
Radno vreme:	Puno
Lokacija i broj izvršilaca:	ASK- 2

Zadaci i odgovornosti:

- Učestvuje u obuci i upoznaje se sa Metodološkim i Organizacionim Uputstvima (osnovnim podacima ankete. Karakterističnim demografskim podacima članova domaćinstva i Individualnom upitnikom) i bude spreman/na da primeni znanja na terenu na osnovu uputstva za Anketu EU-ARS.
- Prikupiti podatke za Anketu EU-ARS metodom CAPI (Tablet računara).
- Vrši identifikaciju svih članova domaćinstva anketiranjem članova koji ispunjavaju kriterijum starosti (15 godina i stariji u svakom domaćinstvu);
- Poštuje uputstva upitnika za pitanja koja ne treba postavljati nekim ispitanicima i prati sve procedure i objašnjenja navedena u instrukcijama;
- Pre napuštanja domaćinstva kontrolniše popunjeni elektronski upitnik da se osigura da su popunjeni odgovori na sva pitanja i sva uputstva praćena.
- Razmotri mogućnost intervjuisanja ispitanika koji se ne mogu intervjuisati tokom prve posete;
- Korišćenje adresa i mapa za određene popisne krugove i domaćinstva;
- Obavesti supervizora o mogućim problemima i neizvesnostima i traži pomoć ako je potrebno;
- Intervjuisanje se sprovodi na jeziku zajednice kojoj pripada ispitanik
- Dnevno izveštava svom supervizoru (Regionalna kancelarija);
- Anketa Domaćinstava treba da se završi u propisanom roku
- Sve dobijene podatke o anketiranim domaćinstvima treba da čuva kao službeno tajnu.
- Vrati opremu primljenu od ASK (Laptop) nakon završetka rada na terenu.

Kvalifikacija/iskustvo:

- Ima završenu najmanje srednju školu
- Ima iskustvo u primeni informacionih tehnologija (laptopa / tableta)
- Prednost imaju kandidati koji su završili viši nivo obrazovanja.
- Prednost imaju osobe koje su pohađale IT kurseve ili koji su učestvovali barem u jednoj anketi sa CAPI metodom.

Kompetencije i veštine:

- Veštine za veoma dobru saradnju i komunikaciju
- Spreman za temski rad;
- Sposobnost prostorne orijentacije(korišćenje mapa za prostornu identifikaciju stambenih objekata);
- Poznavanje rada na računaru word, excel, internet itd;
- Ima dobre organizacione veštine i bude spreman/na da ponekad radi sa dužim radnim vremenom, uključujući i vikendom.
- Da bude iz odgovarajućeg regiona gde će biti sprovedeno Anketa ARS-a

Uslovi učešća na konkursu:

Pravo učešća na konkurs imaju svi punoletni Građani Republike Kosova koji imaju punu sposobnost da deluju, koji su u posedu građanskih i političkih prava, koji imaju potrebnu obrazovnu spremu i stručnu sposobnost za obavljanje potrebnih zadataka i koji imaju fizičke sposobnosti potrebne za odgovarajuću poziciju.

Konkurs je otvoren 5 kalendarskih dana od dana objavljivanja u medijima i na internet stranici ASK-a.

Broj anketara prema etničkoj pripadnosti i regionu:

Rajoni	Anketari albanci
Priština	2

Napomena: U odsustvu srpskih anketara, albanski anketari mogu biti prihvaćeni ako ispunjavaju kriterij priznavanja srpskog jezika, kao i druge profesionalne kriterijume koji se spominju.

Podnošenje prijave: Obrasci za prijavu mogu se dobiti u Arhivi ASK-a, ili se mogu preuzeti sa veb stranice ASK-a: <http://ask.rks-gov.net/>. Aplikacije se uzimaju i dostavljaju u Agenciju za Statistiku Kosova, Ul."Zenel Salihu" br.4, Priština.

Uz aplikaciju potrebno je priložiti: CV¹, kopiju lične karte, dokumenat o prebivalištu, tema diplome ili potvrda za poslednju godinu nivoa obrazovanja (svi dokumenti treba da budu kopije). Zahtjevi poslani nakon poslednjeg datuma neće biti prihvaćeni. Nepotpuni zahtjevi će biti odbijeni. Zbog velikog broja primljenih prijava, samo kandidati koji uđu u uži izbor biće kontaktirani.

Aplikacije poslate poštom smatrat će se važećim sve one aplikacije koje čuvaju datum slanja pošiljke do poslednjeg dana roka isporuke i razmatraju se ako u roku od 3 dana dostave zahtjeve primljene, nakon ovog roka i nepotpune aplikacije neće biti prihvaćene.

Kandidati koji uđu u uži izbor biće usmeno intervjuisani.

Za dodatne informacije možete kontaktirati Kancelariju za Osoblje na broj telefona: 038- 200 31 149 ili 038-200 31 141 od 08:00 – 16:00 časova.

¹ Uključujući: Broj telefona i elektronsku adresu

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ Banesë me qira në Dardani për çift bashkëshortësh. Banesa ka 50 m2 me një dhomë gjumi, sallon e kuzhinë, banjo e ballkon dhe shpajz. Kati i 7 me lift. Çmimi 250 €uro kontakti 044-171328.

▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

▶ Lëshoj lokalim më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

